

BONA MENTE: Përkrahje të Komisioneve për marrëdhënie ndërmjet bashkësive

ANALIZË TË POLITIKAVE

KOMISIONE PËR MARRËDHËNIE NDËRMJET BASHKËSIVE



Instituti për zhvillimin e
bashkësive (IZHB)
www.irz.org.mk

nëntor 2011

**ANALIZË TË POLITIKAVE
KOMISIONE PËR MARRËDHËNIE
NDËRMJET BASHKËSIVE**

Tetova, nëntor 2011

Publikues

Shoqata Instituti për zhvillimin e bashkësive
www.irz.org.mk

Për publikuesin

Sreten Koceski,
Drejtor ekzekutiv

Autor

Ivana Tomovska
Damir Neziri

Ekipi i projektit

Sreten Koceski
Margita Stojanoviq
Skender Mehmeti
Dimçe Josifovski

Këshilltar ligjor

Renata Deskoska

Përkthimi në Gjuhën Shqipe

Nagip Shala

Dizajn

Aleksandar Mançevski

Tirazh: 400

Ky publikim është mundësuar me ndihmën financiare të Unionit Evropian. Ky publikim i përmban qëndrimet e autorit dhe të ekipit të projekti dhe nuk i reflekton qëndrimet e Unionit Evropian

Ky publikim është i shtypur në kuadër të projektit BONA MENTE:
Përkrahje të Komisioneve për marrëdhënie midis bashkësive

Lista e shkurtimeve

IPA	Instrumenti për ndihmë para-anëtarësuese
KMNB	Komisione për marrëdhënie ndërmjet bashkësive
IZHB	Instituti për zhvillimin e bashkësisë
OJQ	Organizatë joqeveritare
AP	Anëtar i parlamentit (deputet)
UNDP	Programi për zhvillimin e Kombeve të Bashkuara
KB	Kombet e Bashkuara
OSBE	Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë
SHNJVL	Shoqata e njësisve për vetëqeverisje lokale
QIQ	Qendra informative për qytetarë
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
AECSB	Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barabarësi
KERJ	Komisioni evropian kundër racizmin dhe jotolerancës

Përmbajtje

Rezymeja ekzekutive	8
1. Hyrje	9
2. Historia/përshkrimi i KMNB-së	11
3. Hulumtimet dhe çështjet e identifikuara	15
3.1. Roli dhe funksioni i KMNB-ve	17
3.2. Anëtarë të KMNB-ve	22
3.3. Rregullore	25
3.4. Finansimi dhe puna e KMNB	27
3.5. Marrëdhënia mes KMNB dhe Këshillit komunal	28
4. KMNB-ja dhe përfshirja e popullatës më të gjerë	30
4.1. Marrëdhëniet ndërmjet KMNB-ve dhe qytetarëve: komunikimi dhe bashkëpunimi.	30
4.2. Roli i sektorit civil në punën e KMNB-së.	31
4.3. Marrëdhëniet ndërmjet KMNB-ve dhe mediave.	34
5. Rekomandime	36
6. Kontribute	42
6.1. Pyetësorë	42
6.2. Pyetjet nga intervistat thelbësore	51
6.3. Lista e personave të intervistuar.	52
6.4. Lista e pjesëmarrësve në sesionet për trajnim	53
7. Bibliografi	55

Rezymeja ekzekutive

Ky dokument për politikat, i bazuar mbi dëshmi, është i mundësuar me përkrahjen e Instrumentit për ndihmë para-anëtarësuese (IPA) të Bashkimit Evropian – Përkrahje e pjesëmarrjes të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe sigurimin e shërbimeve shoqërore. Qëllimi i këtij projekti është që të përkrahet puna e Komisioneve për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB) dhe ta nxis qëndrueshmërinë e tyre përmes vendosjes së mekanizmave për transferimin e njohurive praktike dhe kompetencave nga KMNB ekzistuese për ata të cilat do të zëvendësojnë, duke siguruar vazhdimësi në punën e tyre. Përforcimi i KMNB-VE do të ju siguroj qytetarëve të cilat vinë nga bashkësi të ndryshme etnike që në mënyrë të plotë ti plotësojnë të drejtat e tyre specifike në komunat multietnike të vendit. Ky aktivitet do të vazhdoj ta përkrah implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në nivel lokal, duke promovuar në të njëjtë kohë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Projekti ndërlihet me përpjekjet dhe aktivitetet e mëparshme të Institutit për zhvillimin e bashkësive (IZHB) - Tetova. IZHB nga viti 2006 ka përpunuar disa programe për përkrahjen e KMNB të vendit përmes aktiviteteve të ndryshme, sikur që janë: ndërtimi i kapaciteteve, punëtori, sesione për trajnim, mbledhje informative, madje edhe ndihmë financiare. Duke filluar nga viti 2009/2010, aktivitetet e IZHB gjatë vitit të kaluar kaluan në sferën e politikave me qëllim që të sigurohen efekte të qëndrueshme të aktiviteteve. Këtë herë **aktivitetet do të përkrahen përmes dhënies së rekomandimeve për politikat me qëllim të aplikohet institucionalizimi i mekanizmave për transferimin e eksperiencave praktike dhe kompetencave nga njëra KMNB në atë e cila do ta trashëgojë.**

Ky projekt është zbatuar gjatë periudhës kohore shkurt 2011 – janar 2012 në bashkëpunim me OJQ-të partnere: Aksioni i femrave – Shkup, Qendra për zhvillimin e bashkësive – Kërçovë, Aleanca e të rinjve – Krushev, Qendra për dialog ndërkulturor – Kumanovë, Akva – Strugë dhe Adora – Tetova. Ekipi i IZHB dëshiron që të shpreh falënderim OJQ-ve për kontributin dhe përkrahjen e tyre në implementimin efiakas dhe në kohë të këtij projekti.

Dokument për politikat përshkruan historinë e KMNB-VE në drejtim të kornizës kronologjike të krijimit të tyre, duke i përfshirë mungesat dhe përparimin gjatë viteve të kaluara. Pjesa e tretë, **Studimi dhe çështjet e identifikuara**, merret me: funksionimin e KMNB-ve, roli i anëtarëve të KMNB-ve, financimi i tyre, si edhe marrëdhëniet midis KMNB-ve dhe anëtarëve të Këshillit të komunave. Gjatë analizës së këtyre çështjeve, politika i merë parasysh përgjigjet e anëtarëve të KMNB-ve, por edhe informacione kthyes nga këshilltarët e komunës dhe nga administrata e komunës. Pjesa e katërt, **KMNB-të dhe pjesëmarrja e opinionit më të gjerë**, bën analizë të një aspekti

tjetër të punës së KMNB-ve, në fakt marrëdhëniET e tyre me tre shtyllat shumë të rëndësishme – qytetarët, shoqëria civile dhe mediat. Në fund, pjesa e pestë jep **rekomandime dhe politika** për përmirësimin e punës së KMNB-ve, të cilat janë të kombinuara në tre kategori: juridike, ndërtimin e kapaciteteve dhe përfshirja. Rekomandimet për politikat i dedikohen të gjithë palëve të interesuara si strategji gjithëpërfshirëse e cila mbulon aspekte të ndryshme të punës së KMNB-ve që të sigurohet funksionim produktiv dhe të pandalshëm të komisioneve, të cilat janë të rëndësishme për çdo qytetarë të vendit.

1. Hyrje

Procesi i decentralizimit në Maqedoni i nxis dhe ka për qëllim ti institucionalizoj parimet e demokracisë inkluzive (përfshirëse) përmes pjesëmarrjes më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Sipas rregullës, ky proces ka nevojë për një qasje të hapur të qytetarëve drejtë institucioneve të nivelit lokal. Nga viti 2002, procesi i decentralizimit, gjithashtu, ka për qëllim që të kontribuoj për përmirësimin e zbatimit të shërbimeve publike përmes sigurimit të shërbimeve më efikase dhe më cilësore për qytetarët. Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe sigurimi i shërbimeve cilësore paraqesin dy elemente kryesore të menaxhimit të mirë, që siguron stabilitet afatgjatë në nivel komunal.

Që të rumbullaksohet parimi i pjesëmarrjes përfshirëse demokratike, pjesëmarrja efektive e qytetarëve që u takojnë bashkësive etnike që nuk janë shumicë është thelbësore për përmirësimin e kohezionit social dhe mund të paraqet strategji afatgjate për eliminimin e tensioneve midis bashkësive të ndryshme. Neni 15 i Konventës kornizë për mbrojtjen e majoriteteve nacionale parasheh që partitë e vendit „do ti krijojnë kushtet e nevojshme për pjesëmarrje efektive të njerëzve që u takojnë majoriteteve nacionale në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në gjërat publike, sidomos për gjërat që i prekin ata“¹. Konventa kornizë e thekson **pjesëmarrjen e njerëzve që u takojnë majoriteteve nacionale përmes mekanizmave këshillëdhënëse**². Përveç kësaj, është me rëndësi që organet e përcaktuara këshillëdhënëse të kenë formë juridike që të mundën krejtësisht ta plotësojnë funksionin e tyre. Në

¹ Koment i pjesëmarrjes efektive të personave që u takojnë majoriteteve nacionale në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në gjërat publike. Këshilli Evropian – Komisioni këshillëdhënës të Konventës kornizë për mbrojtjen e majoriteteve nacionale (Strasburg, 2008), faqe 4.

² Ibid. faqe 28.

këtë rast, Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)³ paraqesin mekanizma këshillëdhënëse dhe për të mirën e të gjithëve është që të sigurohet funksionimi i tyre i drejtë.

Komisionet paraqesin mekanizma vitale për informimin dhe ndërmjetësimin e çështjeve të natyrës ndëretnike në nivel lokal në kuadër të komunës. Nga këndvështrimi juridik, KMNB-të kanë kapacitete ta zbatojnë parimin e Badinterit⁴ në punën e Këshillit të komunave, me që paraqesin organe relevante. Por, puna e KMNB nuk ishte efikase dhe në nivelin e duhur sikur që kishte nevojë gjatë viteve të kaluara, krahas potencialit të tyre të madh. Gjatë viteve të kaluara IZHB ka identifikuar një numër të madh të çështjeve që kanë të bëjnë me punën e KMNB, të cilat mund të kategorizohen në disa grupe:

- mungesë të mekanizmave për përkrahjen e vazhdimësisë të KMNB pasi që të krijohet struktura e re administrative;
- mungesë të transparencës dhe informacione (mungesë të bazës së të dhënave e organizuar, sistematike dhe precize për punën e KMNB të komunave) që mund ti përdorin qytetarët e komunës;
- mospërfshirjen e qytetarëve në punën e KMNB.

Sipas raportit të UNDP, në të cilin vlerësohet dialogu multietnik dhe bashkëpunimin e në vend, KMNB nuk e kanë rolin e vet këshillëdhënës dhe preventiv dhe nuk japin rekomandime reaktive⁵. Në vend të kësaj, me çështjet ndëretnike merren liderët lokal politik dhe kryetarë të komunave, ndërsa administratat lokale, gjithashtu, kanë tendenca ti anashkalojnë komisionet⁶.

³ Fjalët „Committees“ dhe „Commissions“ përdoren në mënyrë reciproke në gjuhën anglishte duke marrë parasysh se në raportet tjera ndërkombëtare përdoret fjala „Commissions“ në vend të fjalës origjinale „Committees“.

⁴ Parimi i Badinterit është i definuar në amendamentin X të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ku thuhet: „Për ligjet që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimi i simboleve, Kuvendi vendos me shumicë të votave të deputetëve prezent të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë“.

⁵ Национални и локални капацитети за зајакнување на меѓуетничкиот дијалог и соработка. Програма за развој на Обединетите нации (УНДП), *Програма на ОН за подобрување на меѓуетничкиот дијалог и соработката* (Скопје, 2010), стр. 5.

⁶ Ibid стр. 5.

2. Historia/përshkrimi i KMNB-së

„KMNB-ja instrument i shkëlqyeshëm për përfshirje institucionale të bashkësisë joshumicë në procesin e vendimmarrjes të politikave“ – Ardita Dema, Zëvendës drejtor i SHNJVL-së

„KMNB-ja e prezanton frymën e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit“ – Xhevat Ademi – deputet dhe Kryetar i mëparshëm i Komitetit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë

Zhvillimi dhe reformat pas konfliktit, lidhur me decentralizimin e pushtetit të Republikës së , bazohen në Marrëveshjen Kornizë të Ohrit. Sipas këtij dokumenti, të gjitha bashkësitë etnike kanë të drejtë për përfaqësim adekuat në institucionet etnike si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. Me qëllim që të sigurohet përfaqësimi adekuat dhe të zgjidhen çështjet të cilat i prekin bashkësitë etnike, Ligji për vetëqeverisje lokale nga viti 2002⁷ e përcaktoj krijimin e Komisioneve për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB) në komunat ku më së paku jetojnë 20% të qytetarëve që nuk janë shumicë në vend. Ekspertët e kanë komentuar rregullën për 20% në këtë mënyrë:

„Neni 55 nga Ligji për vetëqeverisje lokale, i cili e rregullon punën e KMNB-së, është restriktiv, pragu nga 20% është shumë i lartë“⁸.

„Sipas meje, ky lloj i komisioneve duhet të jetë formohet në të gjitha komunat, pa marrë parasysh përqindjen e popullatës, pasi që çdo komunë që ka së paku një person që ka nevojë për mbrojtje të drejtave njerëzore duhet ti plotësoj të drejtat e veta sikur njerëzit që jetojnë në komunat tjera, pasi që të drejtat njerëzore nuk kanë të bëjnë me përqindjeve, të drejtat njerëzore kanë të bëjnë me përkushtimin e sistemit të vendit për mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Në rastet këtilla nuk ekzistojnë përqindjet, shteti ose i mbron të drejtat njerëzore e të gjithë qytetarëve ose ka problem me mbrojtjen e të drejtave njerëzore“⁹.

Ligji e përcakton KMNB-në si bord i përhershëm këshillëdhënës të Këshillit të komunës për çështje të cilat i prekin marrëdhëniet ndëretnik.

⁷ Ligji për vetëqeverisje locale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 5/2002; neni 55 Komisioneve për marrëdhënie midis bashkësive.

⁸ Intervistë e zbatuar në tetor 2011 me Xhevat Ademin, deputet dhe Kryetar i mëparshëm i Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në kuadër të Kuvendit të Maqedonisë .

⁹ Intervistë e zbatuar në tetor 2011, me Filip Stojanovskin, koordinator i programeve të Fondacionit Metamorfozis.

Bashkëpunimi midis KMNB-ja dhe Këshilli komunal janë rritur gjatë viteve, por, pas zgjedhjeve të vitit 2009, mosekzistimi i mekanizmave për sigurimin e vazhdimësisë të punës së KMNB-së në komunat rezultoi me **ndalim i aktiviteteve**.

Sipas Raportit për përparim i Komisionit Evropian nga viti 2009 „Komisionet për marrëdhënie ndëretnike janë të formuara në më shumë komuna ku kërkohet nga ligji dhe në 14 komuna të tjera me popullatë më të madhe joshumicë. Megjithatë, zgjedhja e anëtarëve shpesh nuk ishte transparent dhe efikasiteti i këtyre komisioneve është e kufizuar për arsye të kapaciteteve të kufizuara operative, ingerencat e paqarta dhe statutit të dobët. Opinioni në masë të madhe nuk është e vetëdijshme për rolin e tyre dhe rekomandimet e tyre shpesh nuk pranohen nga këshillat komunale. Në disa komuna, përbërja e komisioneve nuk e reflekton strukturën etnike të popullatës lokale”¹⁰. Ngjashëm me këtë, Raporti i progresit për vitin 2010 nuk thekson se ka përparim në këtë sferë¹¹.

Në bazë të sondazheve, analizat dhe raportet e përgatitura nga IZVB gjatë zbatimit të programit „Bona Mente“ – Programi për ndërtimin e kapaciteteve të Komisioneve për bashkëpunim ndërmjet bashkësive (KMNB) të implementuara tre vite me radhë 2006 deri në 2008¹², këto moment/anë negative u theksuan për funksionimin e KMNB-së dhe për Ligjin për vetëqeverisje lokale:

1. mungesë të rregullores së qartë në lidhje se kush do ti emëron anëtarët e KMNB-së;
2. mungesë të rregullores së qartë në lidhje me atë se kurë dhe në çfarë forme Këshilli komunal duhet të kërkoj mendim nga KMNB-ja;

¹⁰ Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, Raporti i progresit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2009», Dokumenti i punës i personelit të komisionit SOM (2009) 533, Bruksel, 14 tetor 2009. faqe 20.

¹¹ Raporti i progresit për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2010, Dokumenti i punës i personelit të komisionit SOM (2010) 660, Bruksel, 9 nëntor 2010.

¹² Gjatë periudhës ndërmjet 2006 dhe 2008, IZHB, në bashkëpunim me Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Shoqata e njësisia për vetëqeverisje lokale (SHNJVL), filluan të punojnë me problematikën lidhur me KMNB-ja përmes organizimit të trajnimeve për anëtarët e KMNB-së dhe e hartuan broshurën për praktikat më të mira të KMNB-së. Pas zgjedhjeve të reja në mars të vitit 2009, IZHB-ja pranoi shumë kërkesa për përkrahje, ndihmë dhe qartësime nga KMNB-ve të reja, si edhe përkrahje për implementimin e programeve dhe projekteve të OJQ-ve lokale nga komunat multietnike.

3. mungesë të listës qartë të definuar të problemeve/çështjeve për të cilat KMNB-ja e jep mendimin e saj deri tek Këshilli komunal;
4. mungesë të rregullores së qartë se a duhet buxheti i komunës të siguroj mjete financiare për funksionimin e KMNB-së komunale;
5. nuk ekzistojnë kritere ose profile për anëtarët e mundshëm të KMNB-së, gjegjësisht, a mundet një person i akuzuar për krime të rënda njerëzimit, jotolerancë ndëretnike ose ndërfetare mund të jenë anëtarë të KMNB-së, duke marrë parasysh senzitivitetin e çështjeve që i shqyrton KMNB-ja;
6. mungesë të dënimeve në raste kur grupe të caktuara dështojnë në respektimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht anëtarëve që kanë lidhje me punën e KMNB-së;
7. mungesë të mekanizmave për monitorim dhe reagim në rast të mungesës të përfaqësimit adekuat gjatë punësimeve të reja në komunat;
8. mungesë të rregullores (nuk ka rregullore) për punën e KMNB-ve të komunave;
9. mungesë të përfaqësimit adekuat: p.sh. Kryetari i KMNB-së të komunës zakonisht nuk është anëtar i grupit joshumicë në nivel lokal;
10. mungesë të kanaleve formale për komunikim ndërmjet një KMNB komunale dhe KMNB në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Sondazhet fillestare për KMNB-të të zbatuara nga IZVB në fund të vitit 2006 tregojnë nivel të ulët të aktiviteteve dhe aktivitete të ulëta, si edhe mungesë të iniciativave në funksionimin e KMNB-ve. Gjatë vitit

2007, nëpërmjet përpjekjeve të OSBE-së dhe IZHB-së, u arritë sukses për sigurimin e nivelit të transparencës në punën e KMNB-ve për mbledhjet e tyre përmes organizimit të evenimenteve në nivel lokal dhe rajonal, si edhe fushata për ngritjen e vetëdijes të administratës komunale për rolin e KMNB-ve, të cilat i prekin çështjet në vijim:

- riemërimin e rrugëve, shkollave dhe objekteve tjera infrastrukurore;
- zbutja e tensioneve që rezultojnë nga incidenteve/problemeve të vogla ndëretnike;
- përdorimi i gjuhëve në komunikimet zyrtare në institucionet publike;
- dhënien e këshillave në Këshillat komunale të cilat i prekin marrëdhëniet ndëretnike.

Aktivitetet e zbatuara në periudhën ndërmjet vitit 2006 dhe mars 2009 kanë treguar rezultate të shquara, si për shembull: të gjitha komunat, nga të cilave është kërkuar të formohen KMNB sipas Ligjit, i kanë krijuar Komisionet¹³. ndërsa edhe në disa komuna që nuk ekzistonte nevoja për formimin e KMNB-ve ata janë formuar¹⁴. Megjithatë, funksionimi i drejtë i organeve të reja në komunat, sikur që janë Komisionet, kërkon kohë dhe përpjekje plotësuese, nëse synimi përfundimtarë është të vendoset praktik e rregullt për diskutimin e çështjeve ndëretnike në nivel lokal. Zgjedhjet lokale në mars të vitit 2009 sollën anëtarë të ri të KMNB-ve, që rezultoi me cikël të ri të ndërtimit të kapaciteteve edhe për anëtarët e KMNB-ve edhe për palët e interesuara primar: OJQ-të lokale, mediat lokale dhe përfaqësuesit e partive politike.

Raportet të cilat bazohen mbi aktivitetet e kaluara, tregojnë se ka nevojë për më shumë punë që KMNB-të të krijohen në **organe më efikase**, të cilat janë të aftë jo vetëm që ti detektojnë arsyet për konfliktet ndëretnike por edhe që të rekomandojnë dhe zbatojnë zgjedhje në kuadër të komunave dhe në të njëjtë kohë të stimulojnë pjesëmarrje aktive të qytetarëve. Detyra e KMNB-ve është që ti dërgojnë të gjitha rastet e bashkësive etnike deri tek Këshillat komunale. Megjithatë, trendet nga e kaluara zbulojnë se çështjet e interesit për dy bashkësitë më të mëdha i

¹³ Komunat të cilat me Ligj janë të obliguara të formojnë KMNB: Brvenica, Vraneshtica, Dibër, Dolneni, Zelenikovo, Jegunovce, Kërçovë, Krushevë, Komanovë, Mavrovë – Rostushë, Petrovec, Sopishte, Strugë, Tetova, Çashka, Çuçer – Sandevo, Qyteti i Shkupit, Butel, Çair dhe Shuto Orizare.

¹⁴ Komunat që në bazë vullnetare kanë formuar KMNB janë: Gostivar, Vrapçishte, Bogovinjë, Drugovo, Karbinci, Konçe, Saraj, Staro Negoriçane, Studeniçan, Delçevë, Gevgeli, Dojran, Kratovë, Vallandovë, Oslomej, Lipkovë.

mbisundojnë nevojat e bashkësive të tjera etnike, të cilat në disa komuna paraqesin numër të rëndësishëm të popullatës. Duhet të ketë përfshirje më të madhe të **bashkësive joshumicë**¹⁵ që nuk i përfaqësojnë dy bashkësitë më të mëdha, shqiptare dhe maqedonase, në komunat ku këto bashkësi akoma nuk mundën ti artikulojnë qëndrimet e veta për çështje që kanë bazë etnike dhe të cilat drejtpërdrejtë i prekin ata. Përmes këtij aktiviteti kemi ndërmend ta bëjmë këtë përmes involvimit të shoqatave të cilat i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike. Shumë çështje, të cilat janë subjekt të bisedimeve në nivel qendror – për shembull vendimi i Gjykatës Kushtetuese për Ligjin për përdorimin e flamujve – kanë qartë reperkusione mbi marrëdhëniet ndëretnike në nivel lokal. Për këtë arsye, **përforcimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve lokale dhe qendrore të cilat merren me çështje të natyrës ndëretnike** do të jetë një sfidë plotësuese e cila do të trajtohet në vitet e ardhshme.

Sondazhi i vitit 2007 për decentralizimin Misioni i zgjeruar i OSBE-së në Shkup, faqe 31
2004-2006 – KMNB-të kanë ekzistuar vetëm në “letër“;
2006 – vetëm 5 KMNB kanë qenë të llogaritura si aktive (kanë pasur së paku një mbledhje dhe kanë diskutuar për çështje që kanë pasur lidhje me konfliktet e vazhduara në komunën);
2007 – 20 KMNB janë llogaritur si aktive;
2009 – kanë qenë të formuara të gjitha KMNB-të të obliguara me Ligj, si edhe 14 të tjerat, të cilat kanë qenë të krijuara në bazë vullnetare.

3. Hulumtimet dhe çështjet e identifikuara

Ky dokument për politikën bazohet mbi hulumtime të bazuara mbi prova, të cilat kanë qenë të zbatuara në pjesën e parë të kohëzgjatjes së projektit. Nga viti 2006, kur KMNB-të e para zyrtarisht u formuan, nuk ishte zbatuar hulumtim faktik në teren që të vlerësohet situata faktike për funksionimin, resurset dhe statutin e KMNB-ve. Që ky projekt të jetë i suksesshëm kishte nevojë që të zbatohen hulumtime në teren, përkrahur me metoda të tjera cilësore.

Për hulumtimin gjithëpërfshirës ishin të përdorura veglat e radhës metodologjike:

- **shqyrtim i materialeve relevante për themelet**, përfshirë edhe legjislacionin dhe korniza politike dhe raportet/të dhënat në diskonim lidhur me procesin e decentralizimit dhe politikën e pakicave;

¹⁵ Bashkësitë joshumicë në Maqedoni i përfshijnë këto komunitete: Romë, Turq, Vlleh, Boshnjak dhe Serb. Në komuna të tjera ekzistojnë edhe komunitete të tjera, ende më të vogla, sikur që janë Maqedonasit mysliman.

- **hulumtime cilësore:** kanë qenë të përgatitura tre lloje të pyetësorëve, të cilat kanë qenë të distribuuar dhe të mbledhura në pjesën e parë të projektit. Në periudhën prej mars deri më 15 korrik të vitit 2011, gjithsej 313 pyetësor valid kanë qenë të mbledhur me ndihmën e OJQ-ve partnere dhe kanë qenë të përfshira në projektin. Pyetësi i parë ka qenë i përdorur për intervistat e qytetarëve, i dyti që të mblidhen mendimet nga përfaqësuesve të OJQ-ve lokale dhe pyetësi i fundit kishte për qëllim ta vlerësoj gjendjen aktuale të KMNB-ve, anëtarëve të Këshillave komunal dhe të të punësuarve në administratën publike në komunat e caktuara. Pyetësorët përfshinë 21 komuna të vendit tonë¹⁶.
- **metoda e pasuruar cilësore:** në periudhën prej shtator – nëntor 2011 kanë qenë të zbatuar gjithsej 5 (nga 9 të ftuar) intervista thelbësore me palët kompetent dhe ekspertët kryesorë. Mes të intervistuarit kanë qenë nëpunës publik dhe shtetëror, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe sektorit civil, të cilat merren me çështje për përfaqësimin adekuat dhe politikat e pakicave.

Rezultatet e sondazhit dhe informacionet mbledhura nga intervistat kanë qenë të vlerësohet gjendja aktuale lidhur me përfaqësimin adekuat në nivel lokal, njohuria e përgjithshme të detyrave dhe ingerencave të KMNB-ve dhe niveli i përgatitjes për problemeve të grupeve të cilat ne i përfshimë. Të dhënat plotësuese, të cilat u treguan si shumë të rëndësishme, janë mbledhur nga grupet në fokus të përbëra nga më shumë palë të interesuara, të cilat janë mbledhur gjatë sesioneve për trajnim të këtij projekti.¹⁷ Metoda e pasuruar cilësore i ka kufizimet e veta lidhur me vlefshmërisë dhe mundësitë të riprodhimin e rezultateve, por, megjithatë, në këtë rast ai i përmbush qëllimet e veta. Në të ardhmen, vendet e hapura në pyetësorët përmes të cilëve intervistohen qytetarët më mirë është të zëvendësohen me grupet në fokus të qytetarëve. Fokus-grupi e jep bazën e diskutimeve dhe dialogun, dhe mund të ketë rol të rëndësishëm për diskutimin e çështjeve, sikur që është pjesëmarrja e bashkësive joshumicë në nivel lokal.

¹⁶ Komunat që kanë obligim ligjor për formimin e KMNB-ve, plus Komuna e Gostivarit.

¹⁷ Fokus-grupet të zbatuara nga IZHB ndërmjet 15 dhe 18 qershor 2011 në Ohër, të cilat përfshinë anëtar të KMNB-së, të përfaqësuara në nivel lokal, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësues të mediave.

3.1. Roli dhe funksioni i KMNB-ve

Komisionet për marrëdhënieve ndërmjet bashkësive janë të krijuara në atë mënyrë që përfshinë grupe të ndryshme të bashkësive etnike në procesin e menaxhimit dhe të ju ipet mundësi të barabartë të debatojnë për zgjedhjet e pranueshme universale për çështje që e prekin dhe ka të bëjë me identitetin. Në këtë mënyrë KMNB-të kanë rol të dyfishtë në kontekstin socio-politik:

- ata mundësojnë dialog institucional ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, dhe
- ata veprojnë si instrument për sigurimin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, të menaxhuar nga përfaqësuesve të zgjedhur¹⁸.

Sa i përket rolit të KMNB-ve, mendimi i bashkësisë akademike është se „ekziston një ndjenjë se KMNB-të nuk i plotësojnë detyrat për të cilat kanë qenë të krijuara. Çështje që kanë rëndësi më të madhe për grupet joshumicë në nivel lokal nuk janë të diskutuara, ndërsa shpesh KMNB-të nuk konsultohen për çështje që janë pjesë të mandatit të tyre, madje ka edhe raste të tjera kur KMNB-të kanë qenë të konsultuara por mendimi i tyre nuk është marrë parasysh“¹⁹. Përfaqësuesit e OJQ-ve pajtohen se „Mandati i KMNB-ve duhet të zgjerohet, ndërsa ne si organizata të sektorit civil e kemi iniciuar këtë çështje gjatë diskutimeve në forume dhe konferenca të ndryshme“²⁰.

Puna e KMNB-ve në vazhdim rregullohet nga statuti i komunave. Statutet përcaktohen nga:

- bashkësitë e komunave që do të përfaqësohen nga në Komisionet;
- procedura për zgjedhjen e përfaqësuesve nga çdo bashkësi për anëtar të KMNB-ve;
- numri i anëtarëve të KMNB-ve;
- numri i anëtarëve nga çdo bashkësi e cila do të jetë e përfaqësuar në Komisionet. Përveç kësaj, Këshilli i komunës e përcakton numrin e përgjithshëm të anëtarëve të KMNB-së me parakusht që çdo bashkësi duhet të jetë e përfaqësuar me numër të barabartë të anëtarëve.

¹⁸ Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB): Vendosi e mandatit dhe eksperiencat ekzistuese. Instituti për zhvillimin e bashkësisë (Tetova, 2007), faqe 4.

¹⁹ Intervistë e zbatuar në tetor 2011 me Renata Deskoska Profesor në Fakultetin Juridik „Justinjin I “në Shkup.

²⁰ Intervistë e zbatuar në tetor 2011 me Lulzim Haziri, Shoqata për iniciativa demokratike (SHID.)

Nga këndvështrimi administrativ dhe logjik, KMNB-ve duhet të ju sigurohen kushte të caktuara elementare që të mund të funksionojnë. Komunat kanë obligim ti sigurojnë këto kushte, përfshirë këtu: hapësirë për punë (vend ku anëtarët e KMNB-ve do të mblidhen); përkrahje administrative në formë të nëpunësit nga komuna, i cili do të ndihmoj për korrespondencën; buxhet i cili do të përfshinë mëditje për anëtarët e KMNB-ve për ditët kur takohen dhe buxhet për aktivitetet dhe evenimenteve të organizuara ose të përkrahura nga KMNB-të (sikur që janë manifestimet kulturore, evenimente ku përfshihet një popullsi më të madhe)²¹. Disa aktivitete të OJQ-ve të cilat janë aktivë në këtë sferë, të cilat merren me sfidat me të cilat ballafaqohen KMNB-të të komunave, me qëllim që të ju ndihmojnë, të ju sigurojnë informacione KMNB-ve që ata duhet përdorin që të fitojnë ndihmë financiare nga organizatat lokale dhe të huaja. Është me rëndësi të theksohet se këto struktura paraqesin organe të përhershme të Këshillit komunal dhe nuk duhet ta zëvendësojnë rolin e OJQ-ve dhe të roganizojnë aktivitete dhe evenimente pasi që kjo nuk është në pajtim me mandatin e tyre.

Sipas rezultateve të mbledhura nga pyetësorëve, anëtarët e anketuar të KMNB-ve, anëtarët e Këshillit komunal dhe OJQ-ve lokale demonstrojnë njohuri solide për rolin e KMNB-ve në bashkësitë lokale. Nga ana tjetër, qytetarët të cilat kanë marrë pjesë në sondazhin kanë pasur njohuri të kufizuar për rolin e KMNB-ve. Sipas kësaj, 34% të personave të anketuara nuk e kanë ditur rolin e KMNB-ve dhe 65,97% nuk njohin as një (personalisht ose në ndonjë tjetër mënyrë) anëtar të KMNB-së të komunës së tyre. 72,14% nga qytetarëve të anketuar nuk dinë se sa herë ose a janë takuar ndonjë herë anëtarët e KMNB-së gjatë vitit të kaluar. **Për befasi, një numër i caktuar i të anketuarve nga administrata publike nuk njohin asnjë anëtarë të KMNB-së në komunat e tyre (26,19%), nuk e dinë a është takuar Komisioni vitin e kaluar, ndërsa disa prej tyre madje nuk e dinë rolin që KMNB-ja luan në bashkësinë e tyre.** Kjo është, në mënyrë të caktuar, sjellje indiferente e administratës publike ndaj KMNB-së. Siç ishte theksuar në raportin e UNDP-së nga viti 2010 – “Kapacitete kombëtare dhe lokale për përforcimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim” në kuadër të programit të OKB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim:

²¹ Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunat e Maqedonisë. Raport nga hulumtimi. Qendra për hulumtimi strategjike dhe dokumentim – Forum Shkup (Shkup, 2008),faqe 14.

„Çështjet ndëretnike shpeshherë drejtohen liderëve lokal politik, zakonisht në zyrën e kryetarit të komunës, në vend të Komisioneve. Nga këndvështrimi praktik, administrata lokale gjithashtu ka tendencë të anashkalojë Komisionet
“²².

Mungesa e mbështetjes së administratës komunave paraqitet një problem i madh për KMNB-në. Nyjat, në kuptim të nivelit të ndryshëm të arsimit të anëtarëve të KMNB-së si dhe dallueshmëritë në prapavijën e tyre sociale, ekonomike dhe politike, e ndalojnë punën e KMNB-së. Përveç kësaj, mungesa e shkathtësive profesionale tek anëtarët e KMNB-së paraqet një pengesë për aktivitetet e tyre të përditshme. **Kjo nyje duhet të plotësohet me anë të administratës komunale. Shumë prej KMNB-ve nuk kanë trashëguar asnjë dokumentim nga KMNB-të paraprake.** Kjo është edhe një arsye tjetër përse administrata komunale ose personi i caktuar duhet ngushtë të bashkëpunojë me KMNB-në dhe të ka qasje në raportet e tyre dhe arkivat.

Nëse pyetni anëtarët e KMNB-së a kanë kushtet e nevojshme për punë (zyrë, mbështetje administrative, financa), një pjesë prej 66,67% përgjigjen pozitivisht. Njësoj si kjo, edhe përfaqësuesit e Këshillit komunal dhe përfaqësuesit e administratës publike kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje me 75% gjegjësisht 90,48% përgjigje pozitive. Këto rezultate tregojnë që situata është përmirësuar prej 2007-2008, kur pjesa më e madhe e organizatave që janë marrë me çështje që kanë të bëjnë me KMNB, kanë paraqitur mungesë të kushteve për punë të KMNB-së (kryesisht zyra dhe kushte lidhur me buxhetin) si pengesë kryesore për funksionimin përkatës të Komisionit²³. Si plotësim të kësaj, z Xhevat Ademi, deputete dhe ish kryetar i Komisionit për Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, ka deklaruar:


²² Kapacitete kombëtare dhe lokale për përforcimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar (UNDP), Programi i OKB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit (Shkup, 2010), faqe 18.

²³ Shikoni raportin për Vlera të Përbashkëta nga 2007: “Nga kjo, shkaqet kryesore për mosfunksionimin e Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive janë kapacitetet e pamjaftueshme të zhvilluara institucionale. Problemet që e frenojnë funksionimin e tyre janë këto: (1) pamundësia të sigurojnë mjete buxhetore nga komuna (nëse ky është obligim ligjore), (2) pamundësia për të siguruar zyra për punë dhe takime të rregullta, (3) kapacitete të pamjaftueshme për lobim për të tejkaluar këto probleme”, faqe 7. Gjithashtu, shikoni edhe raportin e Forum-Qendrës për hulumtime strategjike dhe dokumentim nga viti 2008, faqe 8.

„Ka raste kur, ndonëse janë plotësuar gjitha parakushtet për funksionim normal të KMNB-së, Komisioni sërish nuk funksionon, sepse përfaqësuesit e bashkësive më të vogla nuk janë të vetëdijshëm për mundësitë që kanë në lidhje me të drejtat e tyre të garantuar me Kushtetutë“²⁴.

Duke marrë parasysh kushtet e përmirësuar fizike për punë, hulumtimi ka vërejtur një përparim të vogël në frekuencën e takimit të anëtarëve të KMNB-ve. Në vitin 2008, Forum-Qendra për hulumtime strategjike ka vërejtur që KMNB-ja më aktive ka qenë ajo e komunës së Sopishtes me 13 mbledhje në vitin 2008, pas asaj vijon KMNB-ja e Tetovës me 10 mbledhje dhe Çairi, gjithashtu me 10 mbledhje, të zhvilluar gjatë vitit 2008. Në vitin 2009, ka rënie të aktivitetit të KMNB-së, që ka ndodhur për shkak të zgjedhjeve lokale në mars 2009. Siç ishte theksuar më herët, zgjedhjet lokale kanë shkaktuar ndërprerje të punës së KMNB-ve në disa komuna për shkak të ndryshimit të anëtarëve dhe mungesës së mekanizmave për transferim të informatave dhe mungesë të përbërjes së re të KMNB-ve²⁵. Megjithatë, gjatë vitit 2010, frekuenca e takimeve është përmirësuar, siç është shprehur në figurën më poshtë.

Sa herë janë takuar anëtarët e KMNB-së nga janar të vitit 2010 deri në mars të vitit 2011? (e shprehur ne %)




Një pjesë prej 28,21% nga KMNB-të janë takuar prej 5 deri 10 herë gjatë vitit 2010, ndërsa 12,82% janë takuar më shumë se 10 herë.

²⁴ Intervistë e zhvilluar me z Xhevat Ademi.

²⁵ Sipas rezultateve të anketës së zhvilluar me ndihmën e projektit BONA MENTE: Mbështetje për KMNB, rreth 89% të anëtarëve të KMNB-së në komunat e mbuluara nga projekti janë të rinj, ndërsa vetëm rreth 11% të anëtarëve kanë qenë pjesë e KMNB-së nga mandati paraprak.

Përveç kësaj, 15,38% të KMNB-ve nuk janë takuar aspak në periudhën prej janar 2010 deri mars 2011. Figura më poshtë tregon shkaqet përse KMNB-të nuk kanë qenë aktiv gjatë vitit të kaluar. Si shkak më i shpeshtë përse nuk janë takuar, anëtarët e KMNB-ve kanë theksuar që nuk është paraqitur asnjë problem i natyrës së tillë që do të krijonte nevojë për gjë të tillë. Kjo deklaratë ishte konfirmuar nga anketimi i këshilltarëve komunal, prej të cilëve 60% janë përgjigjur pikërisht me përgjigjen e njëjtë.

Cilat janë arsytet për të cilat anëtarët e KMNB-së nuk janë takuar?(e shprehur në %)



Puna e KMNB-ve është kritikuar për shkak të ndikimit të kufizuar dhe efikasitetit të dobët në punën. Siç ishte theksuar në raportin e UNDP-së:

„Hulumtimi i zbatuar në vend ka përcaktuar që KMNB-të zakonisht kuptohen si “jofunksionale me besueshmëri shumë të ulët ose kapacitet për të trajtuar problemet ndëretnike në nivel lokal”. KMNB-të që funksionojë tregojnë një spektër tjetër të veçorive – prej përbërjes deri tek rregullat dhe frekuenca e takimeve. Shumë KMNB e ndajnë karakteristikën e takimit vetëm për hir të punës, e jo takimi për të diskutuar çështje këshillimore, parandalimi ose reagimi të cilat prekin ose fusha jashtë mandatit të tyre të zakonshme, siç janë transformimi i konflikteve ose menaxhimi i dallimeve dhe integrimi i rrjedhave kryesore”²⁶.

²⁶ Kapacitete kombëtare dhe lokale për përforsimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim.

Shumë prej dobësive të brendshme të KMNB-ve mund të jenë për shkak të mungesës së memories institucionale dhe mungesës së mekanizmave për transferim të njohurive praktike dhe historikun e punës në përbërjen vijuese të KMNB-ve. Shumë prej këtyre dobësive mund të shmangen nëse vendosen dhe transferohen kapacitete të caktuara juridike, institucionale dhe njerëzore. Siç theksohet në raportin e UNDP-së: “Ndonëse ka dobësi institucionale, KMNB-të kanë thelbësore për zgjidhjen dhe informimin mbi çështjet ndëretnike, shprehur me anë të rolit të tyre për të zbatuar parimin e Badenterit në punën e Këshillave komunave”²⁷.

Mekanizma për punën e KMNB :

- Administrata komunale të përfshihet më tepër në punën e KMNB-ve dhe të sigurojë mbështetjen e duhur logjistike dhe administrative.
- Dokumentim përkatës dhe arkivim të dosjeve nga të gjitha mbledhjet e KMNB-ve, aktivitete, çështje dhe arritje (elektronike, si dhe dosje të shtypura).
- Bashkëpunim mes komunave dhe bashkëpunim me KMNB për të shkëmbyer praktikat e mira.

3.2. Anëtarë të KMNB-ve

Për zgjedhjen e anëtarëve të KMNB-ve ekzistojnë disa metoda të mundshme:


- **nominim nga ana e Komisionit komunale për nominim dhe zgjedhje** – pas konsultimit me palët relevante të interesuar (partitë politike dhe shoqatat e regjistruar dhe OJQ-të e bashkësive që jetojnë në komunën);
- **thirrje publike** për aplikim të kandidatëve;

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar (UNDP), Programi i OKB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit (Shkup, 2010), faqe 18. Përveç kësaj, shikoni edhe analizën e prof. Treneska-Deskoska: “Pjesa më e madhe e Komisioneve nuk funksionojnë mirë dhe kanë shumë pak besueshmëri. Zgjidhjet e problemeve të ndryshme nuk jepen shpesh këtyre komisioneve. Komisionet nuk janë mirë të definuar dhe nuk funksionojnë. Mungesat aktuale kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve dhe kapacitetin e tyre institucional. Nuk ka sistem institucional për përfundim të procesit, nuk ka themelim të qartë të komisioneve dhe detyrave të tyre” (faqe 12).

²⁷ *Kapacitete kombëtare dhe lokale për përforcimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar (UNDP), Programi i OKB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit (Shkup, 2010), faqe 18.*

- **mbledhje të qytetarëve** nga grupe të caktuara të bashkësive/grupe etnike;
- **propozim të kryetarit të komunës** konfirmuar me votat e anëtarëve të Këshillit Komunal;
- **anketë të anëtarëve të bashkësive**²⁸.

Në çfarë mënyrë zgjedhen anëtarët e KMNB-së në komunën tuaj? (e shprehur në %)



Sipas hulumtimeve, 53,85% të anëtarëve të anketuar të KMNB-ve kanë theksuar që kanë qenë të nominuar nga ana e Komisionit Komunal për zgjedhje dhe emërim; **përveç kësaj, një numri i anëtarëve të KMNB-ve, 41,03%, kanë qenë të nominuar dhe zgjedhur nga këshilltarët komunal.** Kjo është një informatë interesante, që e imponon çështjen e problemit që parashtrohet rreth transparencës dhe legjitimitetit të procesit të nominimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të KMNB-ve. Disa raporte kanë theksuar për mundësinë e ndikimit politik mbi procesin e nominimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të KMNB-ve dhe sipas kësaj, edhe mbi punën e tyre. Siç ishte theksuar në analizën e Deskosës:

„Një problem tjetër gjatë përbërjes së Komisioneve është ndikimi i lartë politik mbi procesin e nominimit të anëtarëve të saj...Gjithashtu, nominimi dhe zgjedhja e anëtarëve të jashtëm të Komisioneve në disa komuna bëhet në

²⁸ Komisione për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive (KMNB): Themelimi, mandati dhe përvojat ekzistuese. Instituti për Zhvillim të Bashkësisë (Tetovë, 2007), faqe 7-8, gjithashtu shikoni edhe **Udhëzues praktik për punën e Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive**. Lulzim Haziri, Margarita Stojanoviç, Skender Mehmeti, Abdulaziz Fejzullahu, Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) (Shkup, 2009), faqe 11.

*mënyrë jotransparente dhe ata janë ekspozuar mbi ndikimin politik nga ana e koalicionit në pushtet*²⁹.

Përveç kësaj, anëtarët e KMNB-ve, mund të jenë të brendshëm – këshilltarë komunal dhe të jashtëm – anëtarë të respektuar të bashkësisë³⁰. **Në disa komuna, të gjithë anëtarët e KMNB-ve janë anëtarë të Këshillit Komunal**³¹. Për këshilltarët mendohet se janë të nënshtruar ndikimit politik, por sërish, fakti që ata, gjithashtu, dominojnë dhe zgjedhin anëtarë të jashtëm, e bën ndikimin më të madh dhe të pashmangshëm. Për të lobuar për mendimin e KMNB-ve para Këshillit Komunal, mire është ketë anëtarë nga Këshilli Komunal si anëtarë të KMNB-ve.. megjithatë, bashkësitë etnike që nuk janë përfaqësuar në Këshillin Komunal duhet të dominojnë anëtarë të jashtëm në KMNB-në³². Kemi edhe disa çështje relevante për përputhje të roleve të anëtarëve të Këshillit Komunal dhe anëtarëve të KMNB: roli i paqartë i këshilltarëve komunal si anëtarë të KMNB-ve dhe mungesa e mekanizmave për transferimin e njohurisë në momentin kur GJITHË anëtarët e KMNB-ve ndryshohen dhe në kohën e njëjtë ju skadon mandati. Kohëzgjatja e mandatit të KMNB-ve duhet të jetë i ndryshëm nga mandati i anëtarëve të këshillit komunal (mandati i kryesuesit të KMNB-ve të jetë pesë vite në vend të katër)³³. Sipas kësaj, duhet të bëhen disa përshtatje për të siguruar këto mekanizma. Sipas z Filip Stojanovski nga Fondacionit Metamorfozis: *“Mënyra e zgjedhjes së përfaqësuesve të bashkësive të ndryshme etnike që janë pjesë e KMNB-ve, posaçërisht legjitimiteti i tyre, paraqet një problem të vështirë. mungojnë kritere të qarta ligjore për atë se kush mund të konsiderohet si përfaqësuesi i vërtetë i një bashkësie përkatëse. Për momentin mjafton që një person të jetë i emëruar nga udhëheqësia komunale për të shpallur për anëtar të ndonjë bashkësie etnike, pa ndonjë proces që do të garantonte që ky person me të vërtetë përfaqëson atë bashkësi etnike dhe do të mbrojë të drejtat e tyre kolektive*³⁴. Përveç kësaj, z Lulzim Haziri nga Shoqata për Iniciativa Demokratike thotë:

²⁹ Deskovska R., *Mekanizma kushtetuese për dialog ndëretnik në Republikën e Maqedonisë*, Shkup, Justinian I, 2009, faqe 13. Përveç kësaj, shikoni edhe raportin nga vitit 2008 i Forum-Qendrës për hulumtime strategjike, faqe 13 dhe raportin për Vlerat e Përbashkëta nga viti 2007.

³⁰ Sipas rezultateve të anketës së zhvilluar me ndihmën e projektit BONA MENTE: Mbështetje për KMNB, rreth 35% të KMNB-së përbëhen vetëm prej anëtarë të jashtëm ndërsa rreth 40% të KMNB-së përbëhen edhe nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm.

³¹ Komuna ku gjithë anëtarët e KMNB-së janë anëtarë të Këshillit Komunal: Jegunovcë, Dollneni, Çuçer-Sandevë, Çashkë.

³² Sesion i trajnimit zbatuar nga IRZ, grupi 1, 15-16 qershor 2011.

³³ Sesion i trajnimit zbatuar nga IRZ, grupi 1, 15-16 qershor 2011 .

³⁴ Intervistë me z. Filip Stojanovski.

„Struktura e KMNB-ve është shumë e rëndësishme, posaçërisht pjesa e mënyrës së zgjedhjes së anëtarëve të KMNB-ve...kjo duhet të jetë një proces më voluminoz, që do të përfshijë organizatat e sektorit qytetar që mund të ndihmojnë në këtë proces duke dhënë propozime dhe emra të qytetarëve që pushteti lokal i njeh dhe që do të përfaqësojnë interesat e bashkësive më të vogla. Këto bashkësi më të vogla duhet të jenë më aktive sepse nuk kanë përfaqësues në Këshillat Komunal dhe kjo është mundësi e mirë për ata të promovojnë kulturën e tyre dhe nevojat para Këshillit Komunal“³⁵.

KMNB-ja e Jegunovcës përbëhet nga pesë anëtarë dhe gjithë pesë janë anëtarë të Këshillit Komunal (dy shqiptarë, dy maqedonas dhe një serb). Deri më tani, KMNB e Komunës së Jegunovcës ka mbajtur dy mbledhje: njëra kur ithe themeluar KMNB-ja dhe e dyta kur miratoheshë Rregullorja e KMNB-ve. Statuti momental i Komunës së Jegunovcës nuk lejon që persona të jashtëm të bëhen anëtarë të KMNB-ve, andaj pas miratimit të ndryshimeve në Statutin komunal, anëtarët e KMNB-ve që vinin në sesionet për trajnim do të propozojnë zgjerim të KMNB-ve me tre anëtarë tjerë të jashtëm (një serb dhe dy rom) me thirrje të hapur për propozim për të arritur përfaqësim reciprok në KMNB te bashkësive etnike që jetojnë në Jegunovcë.

Tre çështje në lidhje me përputhjen e anëtarëve të KMNB-ve me anëtarët e Këshillit:

- ndikimi politik;
- rol i paqartë me qytetarët;
- përfundim i mandatit.

Mekanizma:

- proces qartë i definuar dhe transparent për zgjedhje të anëtarëve të KMNB-ve;
- mandate të ndryshme për anëtarët e brendshëm dhe jashtëm të KMNB-ve;
- sigurimi i numrit minimal i anëtarëve të jashtëm të KMNB-ve.

3.3. Rregullore

Rregullorja e procedurave paraqet një dokument zyrtar i domosdoshëm për të përcaktuar gjitha çështjet dhe problemet në lidhje me punën e KMNB-ve, pa mos u ngarkuar me përmbajtje të tepër Statuti komunal. Rregullorja paraqet një përmbledhje të rregullave dhe rregulloreve për përdorim të brendshëm të KMNB-ve, e cila përcakton punën e saj dhe duhet të hartohet dhe miratohet nga vetë anëtarët e KMNB-ve³⁶.

³⁵ Intervistë me z. Lulzim Haziri.

³⁶ Udhëzues praktik për punën e Komisioneve për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive. Lulzim

Rregullorja definojnë çështje siç janë: procedura për themelimin e KMNB-ve, procedura për zgjedhje të kryetarit të KMNB-ve, rregullat dhe obligimet e anëtarëve dhe kryetarit të KMNB-ve, procedurat e punës, takimet e rregullta dhe parregullta dhe gjuhët që do të përdoren, afatet për informim të anëtarëve dhe shpërndarje të materialeve të punës, dispozitat për transparencë të punës së KMNB-ve, mënyrat e bashkëpunimit me OJQ-të dhe zbatimi i parimeve për shumicë gjatë miratimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Sipas kryesuesve të KMNB-ve, hartimi i Rregullores konsiderohet si obligim i administratës komunale, prej këtu edhe pamundësia e anëtarëve të KMNB-ve që vetë të hartojnë Rregulloren, për shkak të mungesës së shkathtësive profesionale, ndërsa mungesa e Rregullores së miratuar mund të konsiderohet si mënyrë e pengimit të punës së KMNB-ve nga këndvështrimi procedural³⁷. Siç theksohet në raportin e UNDP-së: “Për momentin, shumë prej Komisioneve nuk kanë miratuar aktin e tillë, dhe në tërësi, zbatojnë punën e tyre duke u bazuar në Rregulloren për Procedura të Këshillit të Komunës, e cila zakonisht përfshin punën e organeve afatgjata të Këshillit dhe jo organeve *sui generis*, siç janë edhe komisionet”³⁸. Gjatë kohës së sesioneve për trajnim dhe fokus grupeve të zbatuar në qershor të vitit 2011, si pjesë e projektit Bona Mente, zbatuar nga IRZ, ishte diskutuar çështja e sigurimit të formave të unifikuar të Rregulloreve dhe pjesëmarrësit rekomanduar që **duhet të hartohet dhe shpërndahet një skemë e unifikuar e Rregullores për KMNB**. Kjo me siguri do të lehtësojë procedurën për themelimin e KMNB-ve dhe do të bëjë procesin më efikas. **Një mënyrë të qasjes së kësaj çështje është OJQ sektori të bashkëpunojë me BNJVL-në për të hartuar dhe shpërndarë skemën për Rregulloren dhe Statutin (në pjesën për KMNB) për gjitha komunat që janë të obliguar me Ligj të themelojnë KMNB.**

Haziri, Margarita Stojaniviq, Skender Mehmeti, Abdulaziz Fejzullahu, Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL) (Shkup, 2009), faqe 12.


³⁷ Komisione për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në komunat në Maqedoni. Raporti nga hulumtimi, Forum-Qendër për hulumtime strategjike dhe dokumentim (Shkup, 2008), faqe 7.

³⁸ Kapacitete kombëtare dhe lokale për përforcimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunim. Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuar (UNDP), Programi i OKB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimit (Shkup, 2010), faqe 40/41.

3.4. Financimi dhe puna e KMNB

Sigurimi i përkrahjes financiare për KMNB është elementi kyç për funksionimin e tyre përkatës. Ka dy aspekte të financimit të punës së KMNB: (1) të sigurohen mëditje për anëtarët e KMNB për ditët e mbledhjeve; (2) të përkrahen aktivitetet dhe ngjarjet e organizuara nga ana e KMNB. Ka disa mënyra të mundshme për financimin e punës së KMNB dhe siç theksojnë anëtarët e KMNB, situata aktuale është sikur në vijim:

Në çfarë mënyre finansohet puna e KMNB-së në komunën tuaj ?(e shprehur në %)



41,03% nga anëtarët e anketuar të KMNB janë përgjigjur se puna e Komisionit të tyre është e financuar nëpërmjet buxhetit të shpërndarë nga komuna. **Për momentin, 48,72%, gjegjësisht gjysma e KMNB, nuk kanë mjete financiare në dispozicion për përkrahje të punës së tyre.** Për shkak të natyrës së KMNB, anëtarët e jashtëm të Komisionit shpesh nuk marrin mëditje, për dallim nga anëtarët e KMNB që janë edhe anëtarë të Këshillit, që kanë kompensim total mujor për mëditjet e punëve të tyre. Këto probleme shumë herë u përmendën gjatë diskutimeve të seancave për trajnim. Edhe pse puna e KMNB është zhvilluar në vitin e kaluar dhe më shumë KMNB i kanë kushtet logjistike të nevojshme për punë, ata takohen në baza vullnetare dhe nëse duan ta përparojnë punën nëpërmjet organizimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve, nuk do të jenë në pozitë të bëjnë atë, për shkak të mungesës së plotë të financave. Fakti se KMNB kryesisht mbështeten në buxhetin e shpërndarë nga komuna, i vënë atë në situatë shumë të pakëndshme. Financimi i punës së KMNB varet prej vullnetit të mirë të vendimmarrësve në komunat. Sipas kësaj, KMNB që

kanë përkrahje të pakushtëzuar, veçanërisht nga kryetarët e komunave, mund të nisin më shumë aktivitete. Siç thekson Deskovska: „*Financimi i nevojave lokale është i kufizuar. Të ballafaquar me probleme të tilla, prioriteti i parë i kryetarëve të komunave dhe këshillave komunal është ta bëjnë komunën funksionale. Në situatat e tilla, çështja e përputhjes së llojllojshmërisë etnike shihet se jogjithmonë është prioritet kryesor i organeve lokale*“³⁹.

Një mënyrë për sigurimin e buxhetit për financimin e aktiviteteve të tyre është që KMNB të krijojnë dhe dorëzojnë programe vjetore për punën e tyre tek komunat. Në këtë mënyrë KMNB mund të kërkojnë buxhetin e paraparë që do ju nevojitet për vitin e ardhshëm dhe të sigurojnë mëditje dhe shpenzime shtesë. **Programi vjetor jo vetëm që do ju ndihmon KMNB të funksionojnë në mënyrë më efikase, por gjithashtu do të rrit transparencën e tyre dhe do të përmirëson procesin e planifikimit. Programet vjetore, gjithashtu mund të paraqesin një nga mekanizmat e nevojitur për sigurimin e vazhdimshmërisë në punën e KMNB të anëtarëve të ardhshëm të Komisionit.**

Përpilimi i programit vjetor do t’ju ndihmon KMNB të sigurojnë financa, do të përmirëson efikasitetin e punës së tyre, do të rrit transparencën dhe t’ju jep mekanizma për sigurimin e vazhdimshmërisë në punën e KMNB, duke e dhënë historinë e KMNB anëtarëve të ardhshëm të KMNB.


Mënyra alternative për financim të punës së KMNB: nëpërmjet projekteve dhe duke kërkuar ndihmë të jashtme dhe donatorë.

3.5. Marrëdhënia mes KMNB dhe Këshillit komunal


Roli i KMNB është të jep mendime Këshillit komunal për çështje të natyrës ndëretnike, si dhe një rol shumë të rëndësishëm; zbatimi i parimit të Badenterit në punën e Këshillit komunal. Që të arrihet kjo, duhet të ketë komunikim të papenguar dhe të qartë mes anëtarëve të KMNB dhe Këshillit komunal. Kur u kërkuar nga anëtarët e KMNB të notojnë bashkëpunimin e tyre me Këshillin komunal, 61,54% të rëndësishëm e cilësuan si shumë të mirë dhe të shkëlqyer. Njëlloj, kur pyetja e njëjtë ju parashtrua anëtarëve të Këshillit komunal, 44,44% u përgjigjën pozitivisht, duke e cilësuar bashkëpunimin si shumë të mirë dhe të shkëlqyer.

³⁹ Deskovska P., *Mekanizmat e kushtetutës për dialog ndëretnik në Republikën e Maqedonisë*, Shkup: Justiniani I parë, 2009, fq. 14.

Si e vlerësoni bashkëpunimin mes KMNB dhe Këshillit komunal?(përgjigje të shprehura me % të dhëna nga ana e anëtarëve të KMNB-ve)



Si e vlerësoni bashkëpunimin mes KMNB dhe Këshillit komunal? (përgjigje të shprehura me % të dhëna nga ana e Këshilleve komunale)



Pyetjes se sa shpesh anëtarët e KMNB janë takuar me Këshillin komunal prej janar 2010, shumica prej KMNB janë përgjigjur me „më pak se 5 herë“ - 43,59%, 1,38% janë takuar mes 5 dhe 10 herë dhe 15,38% janë takuar më shumë se 10 herë. Përsëri, 23,08% Nga KMNB kanë deklaruar se aspak nuk janë takuar me Këshillin komunal. Përgjigjet e dhëna nga Këshillat komunal, që ishin me numër të vogël, prapëseprapë se vërtetojnë frekuencën e takimeve me anëtarët e KMNB⁴⁰. Anëtarët e KMNB si shkaqe për mungesën e takimeve me Këshillat komunal:

⁴⁰ Këshilli komunal deklaroi se: 41.67% - më pak se 5 herë; 16.67% - mes 5 dhe 10 herë; 11.11 % më shumë se 10 herë. 30.56% u deklaruan se aspak nuk ka pasur takime.

mungesa e iniciativës nga ana e tyre, mungesa e financave dhe mungesa e hapësirës për takime. Këshilli komunal thotë se shkaqet kanë të bëjnë me mungesën e nevojës/iniciativës nga të dy palët.

Kanalet për komunikim mes KMNB dhe Këshillit komunal: gjithmonë kur në rendin ditor të seancave të Këshillit komunal do të vendoset temë që ka të bëjë me bashkësitë etnike, ka për obligim të informon KMNB, me qëllim që të mblidhen dhe të japin mendim. Sipas kornizës ligjore momentale që rregullon punën e KMNB, mungesa më e madhe është që KMNB i jep mendime dhe këshilla Këshillit komunal që **nuk janë të obligueshme. Afatet për pranimin e përgjigjes nga Këshillat komunal, pasi të marrin mendim prej KMNB nuk janë të definuar në mënyrë precize.**

4. KMNB-ja dhe përfshirja e popullatës më të gjerë

4.1. *Marrëdhëniet ndërmjet KMNB-ve dhe qytetarëve: komunikimi dhe bashkëpunimi*

“KMNB-ja e ka rolin e urës - i bashkon qytetarët e nacionaliteteve të ndryshme”

qytetar i komunës së Çairit

Qytetarët janë target grupi i drejtpërdrejtë dhe shfrytëzuesit kryesor të shërbimeve të KMNB-ve dhe komunës në përgjithësi. Qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen KMNB-ve me kërkesa të drejtpërdrejta, të parashtrajnë pyetje, të japin komente dhe të dorëzojnë ankesa. **Me qëllim që të shfrytëzohet ndihma e KMNB-ve, qytetarët duhet: (1) të jenë plotësisht të informuar për rolin dhe mundësitë që mund t'ua ofrojë KMNB-ja dhe (2) duhet qartë të kenë të definuar mekanizma dhe kanale për komunikim të pandërprerë dhe efikas me KMNB-në.**

Siç u theksua në pjesën 2.1 Roli dhe funksioni i KMNB-ve, qytetarët e anketuar kishin kuptim shumë të kufizuar për KMNB-në (34% - nuk e dimë se cili është roli u KMNB-ve dhe 65,97% - nuk e njoh (as personalisht e as në ndonjë mënyrë tjetër) asnjë anëtarë të KMNB-ve në komunën time, 72,14% nuk e dinë nëse anëtarët e KMNB-ve janë takuar

gjatë vitit të kaluar). Kur u pyetën qytetarët ta vlerësojnë bashkëpunimin e tyre me KMNB-në 52,78% e kualifikuan si shumë të keqe ose të keqe. Në pyetjen se cilën metodë e shfrytëzoi KMNB-ja për komunikim me qytetarët, përveç opsioneve të dhëna (ueb faqe, debate publike, qendra për informim të qytetarëve me mediume, afishe etj). 40% të qytetarëve janë përgjigjur se nuk e dinë, ndërsa 13,13% kanë shënuar se KMNB-ja aspak nuk ka komunikuar me qytetarët. Përveç kësaj, 87,5% të qytetarëve asnjëherë nuk kanë vizituar ndonjë rast që ndërlidhet me punën e KMNB-ve. Nga ata që dhanë përgjigje pohuese, në 52,38% të rasteve, evenimentet ishin të organizuara nga organizata të sektorit civil. Ka shumë pak ankesa të drejtpërdrejta, që qytetarët i kanë dorëzuar në KMNB. KMNB-ja raporton se. KMNB-ja raporton se në 12 komuna (nga 21 të anketuara) nuk ka pasur ankesë të qytetarëve të dorëzuara drejtpërsëdrejti në KMNB. Numri më i madh i ankesave të drejtpërdrejta të qytetarëve për vitin e kaluar vijonë nga Gostivari (3), Çashka (5) dhe Tetova (5).

Këta të dhëna nuk na befasojnë, por megjithatë janë dështuese. Është interesant të potencohet se qytetarët dhe anëtarët e KMNB-ve dhe anëtarët e këshillit të komunës, në pyetjen e hapur: “A mendoni se ka nevojë për trajnime plotësuese për KMNB-në dhe për çfarë teme”, ishin përgjigjur se duhet të fokusohen në informimin e qytetarëve për rolin dhe punën e KMNB-ve në komunën e tyre. Gjithashtu, krijimi i kanaleve të qarta me KMNB-në do të jetë me rëndësi vitale për strategjinë gjithëpërfshirëse. Këta kanale duhet të përfshijnë: ditë të hapura; formularë, të cilët qytetarët mund t'i plotësojnë gjatë dorëzimit të ankesave; person të emëruar për kontakt me Qendrat për informim të qytetarëve⁴¹. Partnerë shumë të rëndësishëm në këtë strategji për përfshirje të organizatave vendore nga sektori civil dhe mediat lokale.

4.2. Roli i sektorit civil⁴² në punën e KMNB-së

Pjesëmarrja dhe përfshirja e organizatave të sektorit civil në punën e KMNB-së do të kontribuojnë në avancimin e tyre në më shumë mënyra: (1) rritje të kapaciteteve të anëtarëve të KMNB-së; (2) zbulim dhe raportim për çështje që burojnë nga komunitetet e KMNB-së; (3) sigurimi i transparencës më të madhe dhe llogaridhënies së punës së KMNB-së;

⁴¹ Bojaxhieva, A. Udhëheqës për komisionet interetnike, Vizionet e përbashkëta dhe Fondacioni Metamorfozis (Shkup, 2011), fq. 25.

⁴² Termet “organizata të sektorit civil” (OSC) dhe “organizata joqeveritare” (OJQ) do të përdoren si sinonime në këtë tekst.


(4) roli i kanalit të drejtpërdrejtë për komunikim ndërmjet qytetarëve dhe KMNB-së.

Në përqindje e lartë, 87,18%, të anëtarëve të KMNB-së kanë marrë pjesë në trajnime për përmirësim të punës, prej tyre 61,54% kanë deklaruar se trajnimi është organizuar nga ndonjë OJQ. Ngjashëm me këtë, OJQ-të e anketuara vendore kanë deklaruar se 57,69% kanë vizituar trajnime në lidhje me punën e KMNB-së, prej të cilëve 74,19% janë organizuar nga përfaqësues të OJQ-ve partnere. Shumë është me rëndësi të theksohet se të gjitha OJQ-të, që merren me KMNB, duhet ta kuptojnë qartë Ligjin dhe rregulloret që merren me punën e KMNB-së⁴³. Këta të dhëna bëjnë me dije për rolin e rëndësishëm të OJQ-ve – në nivel vendor dhe shtetëror – në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve të anëtarëve të KMNB-së dhe të OJQ-ve vendore, me qëllim që të përmirësohet efikasiteti i punës së tyre. **Në këtë kontekst, partneriteti me OJQ vendore mund të ketë rëndësi vitale për mbështetjen e punës së KMNB-së, përfshirë edhe mekanizmat për dokumentim dhe përcjellje të diturive të anëtarëve të rinj të KMNB-së, në rastet, në të cilat komuna ose KMNB-ja nuk është në gjendje ta bëjë atë.**


KMNB-ja dhe OJQ-të përdorin metoda të ndryshme për komunikim mes vete. Ndër ta më i shpeshtë është komunikimi elektronik, përmes faqes së internetit të komunës (18% të KMNB-së dhe 25% të OJQ-ve kanë thënë se kjo metodë është më e shpeshtë). Përveç kësaj edhe debatet publike janë mënyrë e shpeshtë për komunikim ndërmjet përfaqësuesve të KMNB-së dhe OJQ-ve (KMNB 24%; OJQ - 15,63%).

⁴³ IZHB-ja ka përvojë pune me OJQ tjera dhe për fat të keq, nuk e njohin sa duhet Ligjin për vetëqeverisje lokale, andaj nuk e interpretojnë si duhet për KMNB-në me të cilin bashkëpunojnë. Me qëllim që të shmangen situata të këtilla të keqkuptimit të ligjeve dhe rregulloreve, OJQ-të duhet të kërkojnë këshillë juridike para se të fillojnë të merren me këtë çështje.

Cilat metoda i shfrytëzon KMNB-ja për komunikim me OJQ-të?(përgjigje të shprehura me % të dhëna nga ana e anëtarëve të KMNB-ve)



Cilat metoda i shfrytëzon KMNB-ja për të komunikuar me QJQ-të?(përgjigje të shprehura me % të dhëna nga ana e QVQ-ve locale)



Kur u pyet KMNB-ja për vlerësimin e bashkëpunimit me OJQ-të, u morën shumë përgjigje të ndryshme: 35,9% e vlerësojnë si shumë të mirë dhe të mirë, ndërsa 30,77% e vlerësojnë si shumë të keq dhe të keq. Është interesant se një spektër të ngjashëm u morr edhe nga OJQ-të, në lidhje me bashkëpunimin e tyre me KMNB-në: 40,38% e vlerësojnë si shumë të mirë dhe të mirë, ndërsa 38,46% e vlerësojnë si shumë të keq dhe të keq. Përgjigjet bëjnë me dije për shumë situata të ndryshme dhe johomogjene në komuna të ndryshme anekënd vendit, në lidhje me bashkëpunimin e KMNB-ve me OJQ-të. Kjo situatë është rezultat i drejtpërdrejtë i situatës dhe pozicionit të ndryshëm të OJQ-ve vendore në komunat e tyre, si dhe ndikimit dhe statusit të ndërtuar me kalimin e viteve. Në disa komuna, tradicionalisht, OJQ-të kanë pozitë më të mirë dhe janë vënë si lojtarë relevantë në nivel vendor, ndërsa në komuna tjera ende ka nevojë që OJQ-të t'i ndërtojnë kapacitetet, që të mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor.

Në kuadër të këtij projekti morri pjesë një rrjet prej shtatë OJQ-ve, të cilat merren me çështje zhvillimore multietnike. Në fakt, secila OJQ ishte ne çift me një komunë, qoftë ajo komunë të cilën gjendet ajo OJQ ose në ndonjë komunë fqinje. Ky grup i OJQ-ve ishte i trajnuar ta ndjek punën e KMNB-ve, me anë të ndërtimit të kapaciteteve dhe shkathtësive për përfaqësim, ndjekje dhe evaluim. Rrjeti i OJQ-ve do të punojë si platformë dhe koalicion për iniciimin e çështjeve të mëtejme, duke nxitur ndjenjën e pronësisë së kësaj iniciative. Detyrat e OJQ-ve në periudhën në vijim do të jenë: dorëzim i vlerësimit të punës së KMNB-ve në IZHB dhe në Delegacionin e Komisionit Evropian në vendin tonë. Do të jetë shumë e dobishme nëse kjo praktikë institucionalizohet, me qëllim që të fuqizohet efikasiteti dhe llogaridhënia e punës KMNB-ve.

OJQ-të shpeshherë implementojnë aktivitetet në terren dhe mund të detektojnë aktivitetet për punën e KMNB-së, madje t'i ndihmojnë asaj në inkorporimin e programeve operative vjetore. Përveç rolit të OJQ-ve, për sigurim të ndihmës teknike dhe logjistike të KMNB-ve, ata kanë për detyrë të prezantojnë, të marrin pjesë dhe t'i mbikëqyrin mbledhjet e KMNB-ve (sesioni për trajnim 15-16 qershor, 2011).

4.3. Marrëdhëniet ndërmjet KMNB-ve dhe mediave

Komisioni këshillëdhënës i Këshillit të Evropës në raportin e vetë për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, ka bërë me dije se “mediumet janë burim i pjesëmarrjes efektive të personave të pakicave kombëtare në veprimtaritë publike”⁴⁴. *“Me rëndësi vitale është që publiku i gjerë të informohet për çështjet relevante për personat e pakicave kombëtare, gjë që duhet të bëhet pjesë e integritetit në rrjedhat kryesore të raportimit të medimeve. Medoemos edhe mediat kryesore, si dhe ato të pakicave duhet të luajnë rol kyç në këtë proces, edhe atë jo vetëm përmes përcjelljes së informacioneve, por edhe përmes promovimit të tolerancës. Njëkohësisht duhet të shmangët politizimi i tepërt i çështjeve të pakicave në media. Përveç kësaj mediumet, në veçanti ato elektronike mund ta lehtësojnë procesin konsultativ me personat, të cilët i përkasin pakicave kombëtare”*.

⁴⁴ Komenti për pjesëmarrje efektive të personave, që vijnë nga pakicat kombëtare n, në jetën kulturore, shoqërore, ekonomike dhe në sferat publike. Këshilli i Evropës – Komisioni këshillëdhënës i Konventë kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare (Strasbur, 2008), fq. 34.

Në këtë frymë, roli i medimeve vendore dhe atyre nacionale dhe mbështetja e punës së KMNB-së nga ana e tyre është i padiskutueshëm. Në veçanti mediat lokale mund të paraqesin kanal për komunikim të të gjitha palëve përkatëse të së KMNB-ve, madje në masë të konsiderueshme mund të kontribuojnë në punën e së KMNB-ve dhe të promovojnë klimë pozitive ndëretnike. Edhe raporti i UNDP-së e vë në pah rolin e mediave në promovimin e tolerancës ndëretnike dhe multikulturalizmit, duke raportuar për shembuj pozitivë: “përkundër kësaj pjesëmarrësit e vërejtën se roli i medimeve në raportimin për çështjet ndëretnike është njëri ndër faktorët kryesorë, që kontribuojnë për tensione mes grupeve ndëretnike. Përfaqësuesit e mediave publike identifikuan dhe ranë në ujdi se ndikimi joadekuat politik dhe qasja jo e drejtë e mediave, e bazuar në “interes etnike” i pengojnë mediat që gjithnjë t’i shfaqin vlerat e ndjeshmërisë dhe etikës gjatë raportimit për çështje ndëretnike”⁴⁵.

Nga të gjitha target grupet e anketuara: qytetarët, përfaqësuesit e OJQ-ve vendore, anëtarët e KMNB-ve, anëtarët e Këshillit komunal dhe autoritet vendore – administrata publike, u kërkua ta vlerësojnë prezantimin e KMNB-ve nëpër media. Të gjitha target grupet pajtohen se nuk ka përfaqësim dhe ekspozim të mjaftueshëm të KMNB-ve në mediat lokale, gjegjësisht e kualifikojnë si të keq ose shumë të keq: qytetarët -57,64%, përfaqësuesit e OJQ-ve - 75%, anëtarët e KMNB-ve - 64,1%, anëtarët e këshillit komunal - 58,33%, administrata publike lokale - 59,52%. Pra, ka nevojë dhe hapësirë për bashkëpunim më të afërt të KMNB-ve me mediet vendore. Ky bashkëpunim mund t’i përfshijë OJQ-të vendore. **Përfshirja e përfaqësuesve të mediave vendore, medimeve në trajnim për punën e KMNB-ve paraqiste praktikë të zakonshme të Institutit për zhvillim të bashkësisë.** Ngjashëm me këtë gjatë sesioneve për trajnim në kuadër të këtij projekti, mediet vendore, të cilat i mbulojnë 21 komujnat përkatëse, prezantuan në sesionet për trajnim dhe e shprehën interesimin e tyre për bashkëpunim më të ngushtë dhe të raportojnë për punën KMNB-ve. Gjatë sesioneve për trajnim, përfaqësuesit e mediave vendore, po ashtu i njoftuan me kornizën ligjore dhe me detajet teknike të punës së KMNB-ve, gjë që iu mundësoi të raportojnë më saktë për funksion dhe rolin faktik të KMNB-ve.

⁴⁵ **Kapacitetet nacionale dhe lokale për fuqizim të dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnike.** Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), *Programi i OKB-së për përmirësimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik* (Shkup, 2010), fq. 6.

5. Rekomandime

Rekomandimet e dhëna në vijim janë rezultat i hulumtimit të bazuar në fakte, të realizuar gjatë periudhës prej marsit deri në qershor të vitit 2011 në 21 komuna, ku në fokus ishin grupe të palëve përkatëse në sesionet për trajnim në qershor dhe intervistat thelbësore me bartësit relevant të vendimeve (gjatë shtatorit dhe tetorit të vitit 2011) dhe të dhënat e prezantuara në raporte të ndryshme nga organizata vendore dhe ndërkombëtare. Rekomandimet kanë të bëjnë me tre aspekte: korniza ligjore dhe institucionale, komponenti njerëzor (ndërtimi i kapaciteteve) dhe komponenti i inkluzivitetit, ndërsa të gjithë janë të kahëzuar drejt përmirësimit të punës së KMNB-ve.

Në faqet në vijim do t'i prezantojmë rekomandimet e përgjithshme të dhëna nga kreatorët e politikave dhe ekspertëve të fushave përkatëse që u intervistuan, si dhe rekomandimet konkrete për ndryshimet që duhet të bëhen me qëllim të përmirësimit të punës së KMNB-ve.

“Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i KMNB-së duhet të behën orvatje për ngritjen e vetëdijes së kryetarëve të komunave, me qëllim që ata të mund të kuptojnë se KMNB-të nuk janë kërcënim për ta, por mund të jenë vetëm në favor të tyre; momenti i dytë, të cilit duhet t'i qasemi është qëndrimi i partive politike, të cilat i përfaqësojnë bashkësitë e mëdha etnike: ata janë të mbyllura, ndonëse duhet të jenë më të hapura, në veçanti ndaj bashkësive më të vogla etnike; pika e tretë në të cilën duhet fokusuar, me qëllim të përmirësimit të punës së KMNB-ve është niveli i vetëdijes së anëtarëve të komisioneve, të cilat duhet ta kuptojnë rolin e tyre të vërtetë”, Xhevat Ademi, ish deputet dhe ish kryetarë i Komitetit për marrëdhënie mes komuniteteve, në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

“Kur të merren parasysh se më shumë se njëzet komuna janë të detyruarave ligj të kenë KMNB, raportet nga terreni bëjnë me dije se roli parësor i KMNB-ve rrallëherë përmbushet në praktikë. Shkaku kryesor për këtë është se komisionet, sipas ligjit janë vetëm trup këshillëdhënës. Në periudhën e kaluar theksuam një sërë ndryshime statutare dhe legjislative, të cilat duhet të bëhen me qëllim që të përmirësohet puna e KMNB-ve, përfshirë edhe verifikimin preciz të mjeteve komunale që i kanë në dispozicion”, Filip Stojanovski, koordinator për programe në fondacionin Metamorfozis

Opinionin i përgjithshëm i të gjithë palëve të intervistuar është se ka nevojë për ndryshim të legjislacionit, i cili e rregullon ekzistimin e KMNB-ve, që sipas personave të intervistuar është shumë restriktiv.

Sipas tyre, ndryshimet, në veçanti duhet të fokusohen në:

- procesin e zgjedhjes së anëtarëve të KMNB-ve (nuk është sa duhet i qartë dhe preciz);
- mbështetje administrative (nga administrata e komunës për KMNB-në);
- alkimi i buxhetit për punën e KMNB-së;
- përcaktim plotësues i rolit të KMNB-së.

Rekomadime
Kornizë juridike dhe institucionale
<p>Ndryshime të nenit 55 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Formulim aktual i nenit 55:</p> <p style="text-align: center;">Neni 55 (Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive)</p> <p>(1) Në komunat ku më së paku jetojnë 20% përfaqësues të bashkësisë etnike që nuk janë pjesë të shumicës përcaktuar nga regjistrimi i fundit i popullatës formohet Komision për marrëdhënie ndërmjet bashkësive.</p> <p>(2) Komisionin sipas paragrafit (1) të këtij neni e përbëjnë përfaqësues me numër të barabartë nga çdo përfaqësues i bashkësive të komunës.</p> <p>(3) Mënyra e zgjedhjes të anëtarëve të Komisionit e rregullon statuti.</p> <p>(4) Komisioni i shqyrton çështjet të cilat merren me marrëdhëniet midis bashkësive të përfshira në komunat dhe jep mendime dhe rekomandime për mënyrën e zgjedhjes së tyre.</p> <p>(5) Këshilli i komunës ka obligim ti shqyrtoj rekomandimet dhe mendimet sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe të vendos në lidhje me to.</p> <p>Ndryshime të propozuara – Rregullimi i aspekteve të caktuara për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të bëhet me LIGJ, në vend se këtë ta bëj statuti i komunës:</p> <p>1) Anëtarët e KMNB-ve të zgjedhen nga Këshilli i komunës me anë të konkursit publik – Kjo do të siguroj transparence në zgjedhjen e anëtarëve të KMNB-ve dhe do të hap mundësi që për anëtarësim në këtë organ të aplikojnë persona të cilët kanë autoritet dhe respektohen në komunat e tyre dhe janë të dedikuar për ndërtimin e marrëdhënieve të mira në komunat e tyre.</p> <p>2) Hyrje në fuqi të mospërputhjes së funksionit anëtar në KMNB dhe anëtarë i Këshillit komunal – praktika e viteve të kaluara tregon se në disa komuna anëtarët e KMNB-ve kanë qenë edhe anëtarë të Këshillit komunal. Kjo ka rezultuar me përsëritjen e debateve nga Këshilli në KMNB-ve, si edhe ndikim më të madh të këtyre anëtarëve në punën e KMNB-ve.</p> <p>3) Rritja e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KMNB-ve që të sigurohet vazhdimësi kur do të ndërrohen organet e pushtetit lokal pas zgjedhjeve lokale. Kjo do të thotë se mandate i anëtarëve të KMNB-ve të jetë 5 vite, ndërsa mandati i anëtarëve të Këshillit komunal është 4 vite.</p>

- 4) Vendosja e afateve me të cilat do të obligohet Këshilli komunal ti shqyrton mendimet dhe rekomandimet e KMNB-ve të dërguara në formë të shkruar në afat kohor prej 15 ditëve nga dërgimi i tyre ose në mbledhjen e radhës të Këshillit komunal.
- 5) Vendosja si obligim që Këshilli komunal të kërkoj mendim nga KMNB-ve për vendimet që miratohen me shumicën e Badinterit (shumica e dyfishtë).
- 6) Vendosja e rregullës që kryetari i KMNB-së të të jetë nga bashkësia etnike e cila nuk është shumicë në atë komunë.
- 7) Rritja e ingerencave të KMNB-ve përmes futjes të së drejtës që Komisioni të jep mendime dhe rekomandime për buxhetin komunal, të cilat duhet të merren parasysh nga Këshilli komunal.
- 8) Vendosjen e obligimeve që Këshilli komunal të siguroj buxhet për funksionimin e KMNB-ve.
- 9) Vendosjen e komunikacionit të rregullt midis KMNB-ve dhe Komisionit për marrëdhënie midis bashkësive në kuadër të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së paku tre here në vit ta informoj Komisionin e Kuvendit për situatat e marrëdhënieve ndër-etnike në komunat e tyre.

Neni i ndryshuar 55 nga Ligji për vetëqeverisje lokale me zgjedhjet e propozuara do të duket kështu:

Neni 55

(Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive)

- (1) Në komunat ku së paku jetojnë 20% nga numri i përgjithshëm i popullatës të komunës të përcaktuara nga regjistrimi i fundit i popullsisë janë përfaqësues të bashkësisë të caktuar etnike formohet Komision për marrëdhënie midis bashkësive.
- (2) Komisioni nga paragrafi (1) i këtij neni e përbëjnë numër të barabartë të përfaqësuesve nga çdo bashkësi etnike të përfaqësuar në atë komunë.
- (3) Anëtarët e Komisionit zgjedhen nga Këshilli komunal me mandat prej pesë viteve në bazë të konkursit publik i cili e publikon Kryetari i komunës.
- (4) Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të komunës përcaktohen nga statuti i komunës.
- (5) Anëtar i Komisionit nuk mund të jetë edhe anëtar i Këshillit komunal.
- (6) Komisioni zgjedh kryetar i Komisionit nga radhët e anëtarëve të Komisionit që nuk janë përfaqësues të bashkësisë që e paraqet shumicën në komunë.
- (7) Komisioni :
 - i shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis bashkësive etnike të përfaqësuar në komunat dhe jep mendime dhe rekomandime për mënyrën për zgjedhjen e tyre;
 - jep mendime për vendimet e rekomanduara të cilat miratohen nga Këshilli komunal me shumicë të paraparë nga neni 41 paragrafi 3 nga ligji.;
 - jep mendime për buxhetin e komunës;
 - jep mendime për përfaqësimin adekuat gjatë punësimeve në administratën e komunës dhe në organizatat dhe institucionet publike të komunës.
- (8) Komisioni është e obliguar që mendimet për rekomandimet nga paragrafi (7) alineja 2 dhe 3 ta dërgoj deri tek Këshilli në afat kohor prej 7 ditëve pas marrjes së kërkesës për dhënies së mendimit.
- (9) Këshilli i komunës i shqyrton mendimet dhe rekomandimet nga paragrafi 7 i këtij neni dhe sjell venim për ata në afat kohor prej 15 ditëve nga dërgimi i tyre ose në mbledhjen e radhës të Këshillit komunal.

(10) Komisioni rregullisht e informon Komisionin e Kuvendit për marrëdhënie midis bashkësive për çështje të cilat janë në kompetencat e saja, së paku tre herë në vit: deri në fund të muajit prill, gusht dhe dhjetor.

(11) Komisioni ka buxhet për funksionimin e tij.

Ndryshimi i nenit 41 nga Ligji për vetëqeverisje lokale

Formulimi aktual i nenit 41:

Neni 41

(Puna në mbledhjet e Këshillit)

(1) Këshilli mund të mbaj mbledhje nëse janë prezent shumica e anëtarëve.

(2) Këshilli vendos me shumicë votash nga anëtarët prezent, nëse vetëm me ligj ose me statut nuk vendoset në tjetër mënyrë.

(3) Rregulloret lidhur me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe alfabetëve të cilat përdoren nga 20% të qytetarëve të komunës, krijimi dhe përdorimi i simbolit dhe flamurit të komunës, miratohen me shumicë votash nga anëtarët prezent të Këshillit, dhe duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët prezent të Këshillit të cilët i takojnë bashkësive etnike që nuk janë shumicë në komunë.

(4) Votimi në Këshillin është publik.

(5) Për çdo mbledhje mbahet procesverbal.

Ndryshimet e rekomanduara:

- 1) Këshilli komunal duhet të kërkoj mendim paraprak nga KMNB-ja për vendimet të cilat miratohen me shumicë të Badinterit në përputhshmëri me paragrafin 3 i nenit 41.

Ndryshimet e nenit 41 do të duken kështu:

Neni 41

(Puna gjatë mbledhjeve të Këshillit)

(1) Këshilli mundet të punoj nëse në mbledhjen janë prezent shumica nga anëtarët e Këshillit.

(2) Këshilli vendos me shumicë votash nga anëtarët prezent, nëse nuk parashihet ndryshe me ligj dhe me Statut.

(3) Rregulloret që kanë të bëjnë me kulturë, përdorimi i gjuhëve dhe alfabetit të cilat e përdorin më pak se 20% të banorëve të komunës, përcaktimi dhe përdorimi i simbolit dhe flamurit të komunës, miratohen me shumicë votash nga anëtarëve prezent, me që duhet të ketë shumicë votash nga anëtarëve present të Këshillit që i takojnë bashkësisë etnike që nuk janë shumicë në komunë.

(4) Para miratimit të vendimeve të paragrafit 3, Këshilli është i obliguar të kërkoj mendim paraprak nga Komisioni për marrëdhënieve ndërmjet bashkësive nga neni 55 të ligjit

(5) Në mbledhjen e Këshillit, sipas rregullës, votohet publikisht.

(6) Për çdo mbledhje mbahet procesverbal.

<p>Të ekzistojnë dispozita standarde në Statutin e komunës – dispozita për punën e KMMB</p> <p>Këta dispozita e përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anëtarësimi në KMNB-të të jetë i hapur për çdo qytetarë; • Rroga të definuara për ÇDO anëtar i Komisionit.
<p>Rregullore (Udhëzim për punë)</p> <p>Komuna të miratoj një model standard për rregulloren.</p>
<p>Komuna të përcaktoj një person nga administrata, i cili do të ketë përgjegjësi për nevojat logjistike dhe përkrahje administrative për punën e KMNB-ja.</p>
<p>Kryetari i komunës të emëroj një person i cili do të jetë përgjegjës për dokumentacionin e caktuar dhe për rruajtjen e dokumenteve për çdo mbledhje, aktivitete, pyetje dhe arritje të KMNB-së në form të shkruar dhe elektronike.</p>
<p>Dorëzimi i dokumentacionit nga një përbërje të KMNB-ja në përbërjen tjetër të jetë për më së shumti 15 ditë nga zgjedhja e përbërjes së re.</p>
<p>Ndërtimi i kapaciteteve</p>
<p>Mbledhje e obliguar të përbërjes së re dhe përbërjes së vjetër të KMNB-së në afat kohor prej 15 ditëve që të përcillen aftësitë dhe të jepet një shqyrtim të shkurtër për aktivitetet e mëparshme.</p>
<p>Trajnim për KMNB-të dhe administratës së komunës për dukshmërinë, komunikimin dhe ngritjen e vetëdijes për rolin e KMMB-së</p>
<p>Këmbimin e praktikave të mira midis KMNB-ve dhe nxitjen e bashkëpunimit midis komunave.</p>
<p>Qëllimi i KMNB-ve: përfshirja e shoqërisë civile dhe të qytetarëve</p>
<p>Partneritet formal me OJQ-të lokale që të përkrahet puna e KMNB-ve, të dokumentohet dhe të transferohet njohuria për anëtarët e ri të KMNB-së në raste kur komuna ose KMNB-ja nuk janë në gjendje ta bëjnë atë.</p>
<p>KMNB-ja të ketë procedurë të standardizuar dhe të unifikuar për ankesë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Të ketë formular tek administratori, Qendrat për informimin e qytetarëve ose në internet faqen e komunës i komunës i cili nuk do të jetë i komplikuar për të plotësuar.</p>

Përcjellja e punës së KMNB-së nga OJQ-të lokale të rregullohet me Rregullore. Përfaqësuesit e OJQ-ve rregullisht të jenë prezent në takimet e KMNB-së dhe të kenë qasje në programin e tyre vjetor, raportit vjetor dhe dokumenteve të punës.

Qytetarët të jenë krejtësisht të informuar për rolin e KMNB-ve dhe mundësitë që ofrohen nga Komisioni dhe të kenë mekanizma dhe kanale qartë të definuara për komunikim të papenguar me KMNB-të.

6. Kontribute

6.1. Pyetësorë

Pyetësorë për qytetarët e anketuar

Hulumtimi kryhet në kuadër të projektit BONA MENTE: Përkrahje për Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, të financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i implementuar nga Institutit për zhvillimin e bashkësive (IZHB) me qëllim që të fitohen sa qytetar, OJQ, anëtarët e KMNB-ve, të punësuarit në administratën dhe anëtarë të Këshillit të komunave janë të informuar me punën, rolin dhe ingerencat të Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunën e tyre.

Komuna: _____

Data e plotësimit të raportit: _____

1. Cili është roli dhe ingerenca e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)?

2. Në çfarë mënyre zgjedhe anëtarët e KMNB-së në komunën tuaj?
 - a) dominohen nga Komisionit të komunës për zgjedhje dhe emërim
 - b) konkurs publik
 - c) përmes tubimit të qytetarëve (si procedur për zgjedhjen e anëtarëve të komuniteteve lokale)
 - ç) propozim nga Kryetari i komunës
 - d) sondazh/votim nga qytetarët
 - dh) nuk e di
 - e) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

3. Në çfarë mënyrë financohet puna e KMNB-së në komunën tuaj?
 - a) buxhet i ndarë nga komuna
 - b) buxhet i ndarë nga pushteti qendror
 - c) përmes donacione
 - ç) momentalisht nuk ka financa
 - d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)
 - dh) nuk e di

4. A keni marrë pjesë në ndonjë eveniment që ka pas të bëjë me punën e KMNB-së në komunën tuaj?

a) PO

6) JO (vazhdoni me pyetje e 6)

5. Kush e ka organizuar atë eveniment për KMNB-në në komunën tuaj?

a) komuna

b) përfaqësues nga pushteti qendror

c) përfaqësues të organizatave joqeveritare

ç) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare

d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

dh) nuk e di

6. A mendoni se ekziston nevojë për trajnime plotësuese për çështje që kanë të bëjnë me punën e KMNB-së dhe në çfarë teme:

7. Si do ta kishit vlerësuar bashkëpunimin e KMNB-së me **qytetarët e komunës tuaj?**

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

8. Sa herë janë takuar anëtarët e KMNB-së me qytetarët e komunës tuaj nga **janar 2010 deri në mars 2011:**

a) më shumë se 10 herë

b) ndërmjet 5 dhe 10 herë

c) më pak se 5 herë

ç) nuk janë takuar

d) nuk e di

9. Si do ta kishit vlerësuar përfshirjen e KMNB-së **në mediat lokale?**

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

10. Cilat metoda i shfrytëzon KMNB-ja për komunikim me qytetarët?
- a) Internet faqen e komunës
 - b) mbledhje publike
 - c) Qendrën për informimin e qytetarëve (QIQ)
 - ç) mediat (TV, radio, gazeta)
 - d) përmes shtypjes së afisheve dhe pllakateve informative
 - dh) KMNB-ja nuk komunikon me qytetarët
 - e) tjetës _____ (ju lutemi tregoni)
 - ë) nuk e di

11. Për cilat çështje duhet të punoj KMNB-ja në të ardhmen që janë prej interesit të qytetarët? (ju lutemi tregoni)

12. A njohin ndonjë anëtar të KMNB-së në komunën tuaj? Ju lutemi tregoni cilin?

Ju faleminderit për kohën dhe interesin që e ndatë për plotësimin e këtij pyetëtori!

Pyetësor për anketimin e përfaqësuesve të njësive për vetëqeverisje lokale (NJVL)

Hulumtimi kryhet në kuadër të projektit BONA MENTE: Përkrahje për Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, të financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i implementuar nga Institutit për zhvillimin e bashkësive (IZHB) me qëllim që të fitohen sa qytetar, OJQ, anëtarët e KMNB-ve, të punësuarit në administratën dhe anëtarë të Këshillit të komunave janë të informuar me punën, rolin dhe ingerencat të Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunën e tyre.

Komuna: _____

Data e plotësimit të raportit: _____

1. Cili është roli dhe ingerenca e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)?

2. Në çfarë mënyre zgjidhen anëtarët e KMNB-së në komunën tuaj?
- a) dominohen nga Komisionit të komunës për zgjedhje dhe emërim
 - b) konkurs publik
 - c) përmes tubimit të qytetarëve (si procedurë për zgjedhjen e anëtarëve të komuniteteve lokale)
 - ç) propozim nga Kryetari i komunës
 - d) sondazh/votim nga qytetarët
 - dh) nuk e di
 - e) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

3. Në çfarë mënyrë financohet puna e KMNB-së në komunën tuaj?
- a) buxhet i ndarë nga komuna
 - b) buxhet i ndarë nga pushteti qendror
 - c) përmes donacione
 - ç) momentalisht nuk ka financa
 - d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)
 - dh) nuk e di

4. A keni marrë pjesë në ndonjë eveniment që ka pas të bëjë me punën e KMNB-së në komunën tuaj?

a) PO

b) JO (vazhdoni me pyetje e 6)

5. Kush e ka organizuar atë eveniment për KMNB-në në komunën tuaj?

a) komuna

b) përfaqësues nga pushteti qendror

c) përfaqësues të organizatave joqeveritare

ç) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare

d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

dh) nuk e di

6. A mendoni se ekziston nevojë për trajnime plotësuese për çështje që kanë të bëjnë me punën e KMNB-së dhe në çfarë teme:

7. Si do ta kishit vlerësuar bashkëpunimin e KMNB-së me **qytetarët e komunës tuaj**?

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

8. Sa herë janë takuar anëtarët e KMNB-së me qytetarët e komunës tuaj nga **janar 2010 deri në mars 2011**:

a) më shumë se 10 herë

b) ndërmjet 5 dhe 10 herë

c) më pak se 5 herë

ç) nuk janë takuar

d) nuk e di

9. Si do ta kishit vlerësuar përfshirjen e KMNB-së **në mediat lokale**?

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

10. Cilat metoda i shfrytëzon KMNB-ja për komunikim me qytetarët?

a) Internet faqen e komunës

b) mbledhje publike

c) Qendrën për informimin e qytetarëve (QIQ)

ç) mediat (TV, radio, gazeta)

d) përmes shtypjes së afisheve dhe pllakateve informative

dh) KMNB-ja nuk komunikon me qytetarët

e) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

ë) nuk e di

11. Për cilat çështje duhet të punoj KMNB-ja në të ardhmen që janë prej interesit të qytetarët? (ju lutemi tregoni)

A njohin ndonjë anëtar të KMNB-së në komunën tuaj? Ju lutemi tregoni cilin?

Ju faleminderit për kohën dhe interesin që e ndatë për plotësimin e këtij pyetësi!

Pyetësor për anketimin e përfaqësuesve të OJQ-ve

Hulumtimi kryhet në kuadër të projektit BONA MENTE: Përkrahje për Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive, të financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa i implementuar nga Institutit për zhvillimin e bashkësive (IZHB) me qëllim që të fitohen sa qytetar, OJQ, anëtarët e KMNB-ve, të punësuarit në administratën dhe anëtarë të Këshillit të komunave janë të informuar me punën, rolin dhe ingerencat të Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunën e tyre.

Komuna: _____

Data e plotësimit të raportit: _____

1. Cili është roli dhe ingerenca e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB)?

2. Në çfarë mënyre zgjidhen anëtarët e KMNB-së në komunën tuaj?
 - a) dominohen nga Komisionit të komunës për zgjedhje dhe emërim
 - b) konkurs publik
 - c) përmes tubimit të qytetarëve (si procedurë për zgjedhjen e anëtarëve të komuniteteve lokale)
 - ç) propozim nga Kryetari i komunës
 - d) sondazh/votim nga qytetarët
 - dh) nuk e di
 - e) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)
3. Në çfarë mënyrë financohet puna e KMNB-së në komunën tuaj?
 - a) buxhet i ndarë nga komuna
 - b) buxhet i ndarë nga pushteti qendror
 - c) përmes donacione
 - ç) momentalisht nuk ka financa
 - d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)
 - dh) nuk e di

4. A keni marrë pjesë në ndonjë eveniment që ka pas të bëjë me punën e KMNB-së në komunën tuaj?

a) PO

6) JO (vazhdoni me pyetje e 6)

5. Kush e ka organizuar atë eveniment për KMNB-në në komunën tuaj?

a) komuna

b) përfaqësues nga pushteti qendror

c) përfaqësues të organizatave joqeveritare

ç) përfaqësues të organizatave ndërkombëtare

d) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

dh) nuk e di

6. A mendoni se ekziston nevojë për trajnime plotësuese për çështje që kanë të bëjnë me punën e KMNB-së dhe në çfarë teme:

7. Si do ta kishit vlerësuar bashkëpunimin e KMNB-së me **qytetarët e komunës tuaj**?

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

8. Sa herë janë takuar anëtarët e KMNB-së me qytetarët e komunës tuaj nga **janar 2010 deri në mars 2011**:

a) më shumë se 10 herë

b) ndërmjet 5 dhe 10 herë

c) më pak se 5 herë

ç) nuk janë takuar

d) nuk e di

9. Si do ta kishit vlerësuar përfshirjen e KMNB-së **në mediat lokale**?

(Nota prej 1 deri në 5, 1=më e dobët, 5=më e mirë.)

1	2	3	4	5
---	---	---	---	---

10. Cilat metoda i shfrytëzon KMNB-ja për komunikim me qytetarët?

a) Internet faqen e komunës

b) mbledhje publike

c) Qendrën për informimin e qytetarëve (QIQ)

ç) mediat (TV, radio, gazeta)

d) përmes shtypjes së afisheve dhe pllakateve informative

dh) KMNB-ja nuk komunikon me qytetarët

e) tjetër _____ (ju lutemi tregoni)

ë) nuk e di

11. Për cilat çështje duhet të punoj KMNB-ja në të ardhmen që janë prej interesit të qytetarët? (ju lutemi tregoni)

12. A njohin ndonjë anëtar të KMNB-së në komunën tuaj? Ju lutemi tregoni cilin?

Ju faleminderit për kohën dhe interesin që e ndatë për plotësimin e këtij pyetësori!

6.2. Pyetjet nga intervistat thelbësore

1. Cili është mendimi i juaj për KMNB-ja si instrument për përfshirje institucionale të bashkësisë joshumicë në procesin e vendimmarrjes?
2. A mendoni se KMNB-ja i shërbejnë qëllimit për të cilën kanë qenë e formuar. A kryjnë punë të mirë gjatë plotësimit të qëllimeve të tyre?
3. Cilat janë arsyt kryesore që kontribuojnë që situata në KMNB-të jetë sikur që e përshkruajmë?
4. Sipas juve si mund të përmirësohet puna e KMNB-ve?
5. A mendoni se korniza ligjore e cila e rregullon ekzistimin e KMNB-ve është e përshtatshme?
 - a. A ka nevojë të ndryshohet korniza ligjore?
 - б. Nëse ka nevojë të tillë, çfarë ndryshime keni ndërmend?
6. Cili është mendimi i juaj për komunikim ndërmjet:
 - a. KMNB-të dhe Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në kuadër të Kuvendit?
 - б. KMNB-te dhe OJQ-të?
 - в. KMNB-të dhe qytetarët?
7. A mendoni se ka diçka nuk ishte e përfshirë me pyetjet paraprake, ndërsa ju doni ta shtoni?

6.3. Lista e personave të intervistuar

1. Ardita Dema – Shoqata e njësisve për vetëqeverisje lokale e Republikës së Maqedonisë (SHNJVL), Zëvendës drejtor;
2. Renata Treneska-Deskoska – Fakulteti Juridik, Universiteti Shën Kirili dhe Metodi - Shkup, profesor;
3. Filip Stojanoskli – Metamorfozis, koordinator i programit;
4. Lulzim Haziri – Shoqata e iniciativave demokratike (SHID) - Gostivar, Drejtor ekzekutiv;
5. Xhevat Ademi – Kuvendi i RM-së, deputet dhe Kryetar i mëparshëm i Komisionit për marrëdhënieve ndërmjet bashkësive në kuadër të Kuvendit të RM-së.

6.4. Lista e pjesëmarrësve në sesionet për trajnim

1. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna e Kërçovës;
2. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna Jegunovce;
3. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna Brvenica;
4. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna Vraneshtica;
5. Përfaqësues nga Komuna e Gostivarit;
6. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna e Tetovës;
7. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna Sopishte;
8. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna Shuto Orizare;
9. Përfaqësues të KMNB-së - Qyteti i Shkupit;
10. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna e Çairit;
11. Përfaqësues nga administrata komunale e Butelit;
12. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna Dollneni;
13. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna e Kumanovës;
14. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna e Dibrës;
15. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna Çashka;
16. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna e Krushevës;
17. Përfaqësues i KMNB-së – Komuna e Strugës;
18. Përfaqësues të KMNB-së – Komuna Çuçer Sandevo;
19. Përfaqësues nga Qendra për dialog ndërkulturor – Kumanovë;
20. Përfaqësues nga Aleanca rinore – Krushevë;
21. Përfaqësues nga OJQ-ja AKVA – Strugë;
22. Përfaqësues nga Aktiviteti i Femrave – Shkup;
23. Përfaqësues nga ADRR Sonce (Dielli) - Tetovë;
24. Përfaqësues nga Qendra për zhvillimin e bashkësive – Kërçovë;
25. Përfaqësues nga OJQ-ja ADORA- Tetovë;
26. Përfaqësues nga Instituri për bashkëpunim ndërkombëtarë – Shkup;
27. Përfaqësues nga OJQ-ja Perspektiva Shkup;
28. Përfaqësues nga OJQ-ja MAC Jegunovce;
29. Përfaqësues nga OJQ-ja Rekanski Biser – Mavrovë - Rostushe;
30. Përfaqësues nga OJQ-ja Meseçina (Hëna) – Gostivar;
31. Përfaqësues nga OJQ-ja Prerodba (Rilindja) – Kërçovë;
32. Përfaqësues nga Qendra e femrave – Dibër;
33. Përfaqësues nga OJQ Festivali rrugor (Уличен фестивал) – Kumanovë;
34. Përfaqësues nga Qendra për zhvillim rural Bujrum – Kumanovë;
35. Përfaqësues nga Polio minus – Shkup;
36. Përfaqësues nga OJQ-ja Shkup – Shkup;

37. Përfaqësues nga OJQ-ja Umbrella – Shkup;
38. Përfaqësues nga OJQ-ja Zora – Shkup;
39. Përfaqësues nga partia politike PDSH - Tetovë ;
40. Përfaqësues nga partia politike LSDM – Vraneshtica;
41. Përfaqësues nga partia politike PDSH- Tetovë;
42. Përfaqësues nga partia politike LSDM – Vraneshtica;
43. Përfaqësues nga partia politike RDK – Gostivar;
44. Përfaqësues nga partia politike BDI – Çair;
45. Përfaqësues nga partia politike VMRO – DPMNE - Petrovec;
46. Përfaqësues nga partia politike LSDM – Kumanovë;
47. Përfaqësues nga TV Menada - Tetovë;
48. Përfaqësues nga Radfio Maqedoni;
49. Përfaqësues nga A! TV;
50. Përfaqësues nga Radio Dibër.

7. Bibliografi

Bojagjiev A. Udhëheqës për komisionet interetnike, Vizionet e përbashkëta Fondacioni Metamorfozis (Shkup, 2011).

Koment për pjesëmarrje efektive të personave që u takojnë majoriteteve nacionale në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe në punët publike. Këshilli Evropian – Komisioni Këshillëdhënës për konventën kornizë për mbrojtjen e majoriteteve nacionale (Strasburg, 2008).

Komisioni i komuniteteve evropiane, « Raporti për progres për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë », Dokumenti punues i personelit të komisionit SOM (2009) 533, Bruksel, 14 tetor 2009.

Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive (KMNB): Formimi, mandati dhe eksperiencat ekzistuese. Instituti për zhvillimin e bashkësive (Tetovë, 2007).

Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive në komunat e Maqedonisë. Raporti nga hulumtimi. Qendra për hulumtime strategjike dhe dokumentacion - Forum (Shkup, 2008).

Deskovska R., *Mekanizma kushtetuese për dialog ndëretnik në Republikën e Maqedonisë*, Shkup: Justinijna I, 2009.

Donçevski Iliq, Keti dhe bashkëpunuesit. ‘Përfshirje për diversitet: Rekomandime për përmirësimin e dialogut ndëretnik në sferën e kulturës në Kumanovë’. Qendra për bashkëpunim ndërkulturor (Kumanovë, 2011).

Raport për të drejtat e njeriut në Maqedoni. Ministri për punë të jashtme të SHBA-ve (2011).

Lloskovska, Gabriella. Të drejtat njerëzore dhe të drejtat e komuniteteve: Praktika, mekanizma dhe mbrojtjen e tyre. Asociacioni për emancipim, solidaritet dhe barabarësi (ESE) (Shkup, 2009).

Dokument për politikë: Përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike në nivel lokal përmes përforcimit të marrëdhënieve ndëretnike me komunat. Vlera të përbashkëta (Shkup, 2008).

Jovanovska, Bojana dhe Stojmenov, Stiv (2010) „Implementimi i multikulturalizmit: përfshirje sociale të majoriteteve përmes reformave për decentralizim në Maqedoni“. shqyrtim i politikave në Ballkanin Perëndimorë Vëllimi 1, Numri 1, jan/qersht 2010 *Qendra për politika publike në Kosovë, Prishtinë*

Kapacitete nacionale dhe lokale për përforcimin e kapaciteteve lokale për përforcimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimin. Programi për zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNDP), Programi i KB-së për përmirësimin e dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimin (Shkup, 2010).

Partitë dhe politikat etnike në Maqedoni. Projekt për marrëdhënieve ndërmjet etnikumeve, Carnegie Corporation of New York (Princeton, 2009).

Dokument për politika: Komisionet për marrëdhënieve ndërmjet bashkësive – mundësi për pjesëmarrje efektive të bashkësive etnike (majoriteteve) në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal në Republikën e Maqedonisë. Vlera të përbashkëta (2007).

Partitë politike dhe pjesëmarrja e majoriteteve. Friedrich Ebert Stiftung (Shkup, 2008).

Udhëzues praktik për punën në Komisionet për marrëdhënie ndërmjet bashkësive. Lulzim Haziri, Margarita Stojanoviç, Skender Mehmeti, Abdulaziz Haziri. Shoqata e njësive për vetëqeverisje lokale. (SHNJVL) (Shkup, 2009).

Raport nga konferenca „Si të bëhen më efektive KMNB-të“. Bojana Bejkova. Vlerat e përbashkëta dhe Fondacioni Metamorfozis (Shkup, 2011).

Raport për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (cikli i katërt i monitorimit) Komisioni Evropian kundër racizmit dhe jotolerancës (KERJ Këshilli Evropian (Strasburg, 15 qershor, 2010).

Strategjia për përfaqësimin adekuat të bashkësitë joshumicë në Republikën e Maqedonisë. Sekretariati për implementimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2007).

Raporti për progres për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2010, Dokumenti punues i personelit të komisionit SOM (2010) 660, Bruksel, 9 nëntor 2010.

Tomovski, I, Zhvillimet aktuale dhe decentralizimi në periudhën pas konfliktit në Maqedoni. Revistë vjetore për çështje që kanë të bëjnë me majoritetet (Brill Publishing, Amsterdam: 2010).

Për Institutin për zhvillim të bashkësisë (IZHB)

IZHB është shoqatë civile e cila ekziston për 15 vite. Në fillim IZHB ishte e formuar që të merret me problemet ndëretnike në rajonin e Tetovës, ndërsa sot funksionon në rreth 30 komuna, duke përfshirë mbi 60% të popullatës. Misioni i IZHB është që ta rrisë mirëkuptimin ndëretnik dhe tolerancën dhe ti përmirësoj kushtet jetësore dhe kushtet jetësore dhe standardet jetësore të qytetarëve. Grupet kryesore të synuara janë bashkësitë etnike që nuk janë shumicë në komunat ku implementohet Marrëveshja Kornizë e Ohrit.

Projekti ndërlihet me përpjekjet dhe aktivitetet e mëparshme të implementuara nga IZHB. Nga viti 2006 IZHB ka dedikuar disa programe të veta për përkrahjen e punës së KMNB-ve në vend përmes aktivitete të shumëllojshme, sikur që janë: ndërtimi i kapaciteteve, punëtori, sesione për trajnim, mbledhje informative, bile dhe ndihmë financiare. Duke filluar nga viti 2009/2010, aktivitetet e IZHB-së gjatë vitit të kaluar kanë kaluar në sferën e politikave me qëllim që të sigurohen efekte të përhershme të aktiviteteve.

**Instituti për zhvillim të bashkësisë
Community Development Institute- Macedonia**

www.irz.org.mk

L. B. Pish 82 Tetova

+389-44-340-677